



Libri i bardhë

për të drejtat profesionale
dhe të punës të gazetarëve



Sindikata e pavarur e gazetarëve
dhe punëtorëve të mediumit

Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve të mediumit

Libri i bardhë

për të drejtat profesionale
dhe të punës të gazetarëve

Shkupi, 2014

Botues:
Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve të mediumit

Redaktor:
Xvezdan Georgievski

Koment juridik:
Dimitar Apasiev

Lektura:
Olivera Qorvezirovska

Përkthimi në gjuhën shqipe:
Besa Drndar

Dizajni:
Zoran Riçliev



**Sindikata e pavarur
e gazetarëve dhe
punëtorëve të mediumit**

ssnm.org.mk



**British Embassy
Skopje**

Përpilimi i këtij publikimi u mundësua me përkrahjen e Ambasadës britanike në Shkup, në kuadër të projektit “Përforcimi i të drejtave të punës në mediumet”.

Mendimet dhe qëndrimet e theksuara në këtë publikim nuk i reflektojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Ambasadës britanike në Shkup.

The British Embassy in Skopje supported the preparation of this publication, within the project “Upholding the labor rights in media”.

The content of this publication does not necessarily reflect the position or the opinions of the British Embassy in Skopje

Përmbajtja:

Hyrje	7
Pushime prej pun Rasti i Biljana Jovanovska dhe kolegëve të saj kundër MPM	13
Kontrata në kohë të caktuar Litar i shkurtër për gazetarët	23
Korrespondentë Të diskriminuar në çdo aspekt	33
Punë me honorar Një armatë gazetarësh janë të detyruar të punojnë “në të zezë”	41
Autocensurë Pronarët, redaktorët dhe politikanët i bën të heshtin, gazetarët pranuan	51
Mediume kritike Ndërmjet mbylljes dhe censurës	61
Hulumtimi Degët e ulëta të gazetarisë maqedonase	73
Anketë Anketë për të drejtat punëtore dhe profesionale në mediumet	77
Për gazetarët dhe ato tjerët	91

Në Sindikatën e pavarur të gazetarëve dhe të punëtorëve të medi-umit në Maqedoni, një kohë të gjatë tani më ndihej nevoja për sintetizimin e problemeve më të mëdha të zhurnalistikës maqedonase në një dokument të veçantë, me qëllim që të bëhet analiza e vështirësive me të cilat ballafaqohen çdo ditë anëtarët e saj dhe gazetarët në përgjithësi. Një nga rezultatet e asaj pjekurie është pikërisht edhe ky studim për të drejtat e punës dhe për standardet profesionale të gazetarëve maqedonas.

INCIZIMI I PIKAVE MË NEURALGJIKE TË ZHURNALISTIKËS MAQEDONASE

Ambicia nuk ishte të bëhet ndonjë incizim kuantitativ thelbësor i pikave më neuralgjike të zhurnalistikës maqedonase, për shkak se, më në fund, parashtrohet pyetje se sa në fakt një gjë e këtillë do të ishte e mundur në këtë çast, para së gjithash, për shkak të jotransparencës së strukturave të mediumit, të elitave qeverisëse dhe të faktorëve të tjerë që e rrumbullakojnë pasqyrën

maqedonase të medimeve por, edhe për shkak të atmosferës së përgjithshme të frikës dhe të dëshpërimit që sundon ndër profesionistët gazetareskë. Këto tregues të supozuar u dëshmuar në mënyrë drastike edhe gjatë procesit të punës mbi Librin e bardhë për të drejtat punëtore dhe standardet profesionale. Një nga karakteristikat manifestuese të dukurive të ekspozuara, të cilën lexuesi kureshtar do e vërejtë menjëherë është - anonimësia e bashkëbiseduesve. Guximin për ti thënë njohuritë e veta nën emrin dhe mbiemrin personal e kishin kryesisht vetëm gazetarët veç më të ekspozuar, respektivisht ato që punojnë në medimet e ashtuquajtura të pavarura, në medimet që në politikën e veta redaktuese i kultivojnë tonet kritikuese ndaj pushtetit. Që, me siguri edhe këto përvoja flasin në masë të mjaftueshme për nivelin në të cilin gjendet gazetaria maqedonase sot.

Megjithatë, edhe kështu siç është i strukturuar dhe i përpiluar, Libri i bardhë përmban mjaft elemente për ta fituar pasqyrën e madhe. Praktikisht, ajo përmban gjashtë tekste dhe një hulumtim, që mbi një ekzemplar reprezentativ të gazetareve maqedonas, për nevojat e Librit të bardhë e bëri Agjencia "M-prospekt". Temat e zgjedhura për përpunim, edhe pse paraqesin gjashtë njësi tekstuale të veçanta, në fakt e topografojnë hartën gazetare maqedonase, dhe kuptohet, si të atilla, krijojnë një tërësi, respektivisht një pasqyrë dhe prerje të me siguri problemeve aktuale më serioze nga fusha e marrëdhënieve të punës dhe standardeve profesionale. Nga këndvështrimi redaktues, parimi i zgjedhjes së temave u fitua pikërisht nga rezultatet e hulumtimit por edhe nga eksplikacionet e vetë autorëve të cilët tezgat e veta i mbronin në konkurs të hapur, të shpallur pikërisht për ti definuar pikat neuralgjike që duhet të përpunohen. Kuptohet se nuk mund të ekstraktohet as kriteri i caktuar subjektiv në krijimin e këtij publikimi.

Edhe pse, në kuadër të përpunimit, në libër janë inkuadruar një sërë bashkëbiseduesish, që do të thotë se praktikisht janë përpunuar dhjetëra raste të çrregullimit të të drejtave gazetare, përpunim më konkret dhe më të tërësishëm ka rasti i gazetareve të "Utrinski vesnik" (nëpërmjet shembullit të Biljana Jovanovskë-s), të cilët e humbën punën për shkak të aktiviteteve sindikale, respektivisht për shkak të protestës spontane. Ky rast është njëfarë lloj pikë referimi në të cilën një precedent shndërrohet në rregull. Gjegjesisht, prej atij çasti, profesionistët më të mirë, me një lehtësi të paparë mbesin pa vendet e tyre të punës, ndërsa arsyet pothuajse asnjëherë nuk janë arsyetuar me jo profesionalizëm, me jo respektim të obligimeve të punës ose po cilësi të pamjaftueshme të punës. Rasti i gazetareve të "Utrinski vesnik" është rast markant edhe për shkak të praktikës gjyqësore jokonsekuente, si edhe për shkak të vendimeve kontroverse dhe përjashtuese të instancave gjyqësore.

Praktika e këtillë, si edhe ndryshimet e shpeshta të Ligjit për marrëdhëniet e punës, mundësojnë që edhe një përjashtim të shndërrohet në rregull – punësim për kohë të caktuar. Respektivisht, kontratat për kohë të caktuar janë me siguri mënyra më e lehtë me të cilën punëdhënësit i mbajnë gazetaret në "pe të shkurtër". Tani më bëhet praktikë që kontrata të vazhdohet çdo muaj, por ndodh që edhe ato kontrata afatshkurta të mos respektohen, kurse gazetaret, pa asnjë arsyetim të mbesin pa punë. Praktika e këtillë shfrytëzohet për disiplinimin e esnafit gazetaresk, gjegjesisht, për kontrollin mbi punën e tyre.

Pozita është e ngjashme edhe me bashkëpunëtorët me honorar. Edhe pse kategori i këtillë i punësimit praktikisht as që ekziston në rregullat ligjore pozitive, është sekret publik se angazhimi me honorar është një nga dukuritë më të shpeshta në mediumet maqedonase. Vështrimi i shpeshtë ndër gishta dhe qasja seleksionuese e organeve inspektuese krijojnë një masë të numrit enorm të gazetareve tërësisht të pambroj-

tur. Karakteristika themelore për këtë grup të gazetarëve është pagesa e dobët, puna jashtë orarit të punës, mospagesa e asnjë kontributi që rrjedh nga marrëdhënia e punës, me një fjalë, pasiguri e tërësishme sociale dhe ekzistenciale.

Vështruar në mënyrë procentuale, numër më të madh të gazetarëve me honorar ka ndër korrespondentët e vendit, të cilët bëjnë pjesë në grupet më vulnerable të gazetarëve. Përveç asaj që janë të paguar nën çdo nivel dinjitoz, ato punojnë në kushte tërësisht supstandarde, duke përdorur mjete vetjake për punë (kompjuterë, foto-aparate, kamera, automobila) dhe shpesh, duke punuar në disa vende pune, me qëllim që të mundën të sigurojnë ekzistencë. Raporti i tyre me “redaksitë qendrore” më së shpeshti mund të karakterizohet si “obligime pa të drejta”, ndërsa nevojat e tyre çdoherë vijnë si të fundit në rendin ditor (nëse edhe vijnë në rend për shqyrtim), ndërsa pritjet për informim në kohë dhe për informim gjithëpërfshirës nënkuptohen. Me një fjalë, korrespondentët janë kategori “e harruar” e gazetarëve.

Aspak më lehtë nuk e kanë as gazetarët të cilët punojnë në mediumet që përpiqen të mbajnë ca standarde më të larta profesionale dhe të cilët deklarohen si të pavarur nga politikat qeveritare. Këto mediume, më së

shpeshti janë në goditje të presioneve serioze sociale-ekonomike, nëpërmjet padive gjyqësore për shpifje, nëpërmjet qasjes seleksionuese deri te mjetet e marketingut, deri në pamundësimin e kryerjes profesionale të punëve.

Pasqyra e këtillë globale, sjell deri aty deri ku sjell – deri në shndërrimin e mediumeve në zëdhënës të qendrave të caktuara politike dhe ekonomike të pushtetit, deri në shfrytëzimin e tyre për interesa të biznesit dhe të politikës, deri në shndërrimin e gazetarëve në punëtorë të llojit shoqëroro-politik të deformuar... Rezultati i gjithë kësaj edhe nuk mund të jetë asgjë tjetër përveç dominimit të joprofesionalizmit, respektivisht të zbatimit masovik të censurës dhe autocensurës, fjalimit të urrejtjes, spinimit, dezinformimit, analfabetizmit...

Edhe pse fokusi është vënë mbi kryerjen e profesionit të gazetarisë, sintetizimi i caktuar i rezultateve që i fitoi Libri i bardhë mund të na shpijnë edhe deri në vlerësimin e nivelit të shoqërisë maqedonase. Për arsye se gjendja katastrofale e hapësirës maqedonase të mediumeve nuk është asgjë tjetër përpos indikatorit për kapacitetet demokratike të vendit. Heqja nga konsumimi i njërës prej të drejtave themelore njerëzore – lirisë së fjalës, më tutje i ndërlikon edhe proceset e përgjithshme shoqërore, politike, sociale, kulturore dhe ekonomike, që detyrimisht sjellin deri në asgjësimin e indit shtetëror, duke e shpjerë vendin në trendë ekskluzive negative – kah shoqëria gjysmë totalitare ku sundo-

LIBRI I BARDHË
PËRMBAN ELEMENTE
TË MJAFTUESHME
QË TË FITOHET
PASQYRA E MADHE

jnë trysnitë, censurat, varësia ekonomike, pushteti i koncentruar, modellet e korruptuara...

Edhe përskaaj asaj që qëllimi fillestar i Librit të bardhë është të alarmojë, nuk është asgjë më pak i rëndësishëm edhe funksioni i tij i dytë – të motivojë. Gjegjesisht, me anë të diagnostikimit të problemeve dhe parashtrimin të tyre ekzakt, mund të vihet edhe deri te terapia për trupin e sëmurë gazetaresk. Domethënë, këto tekste mbesin jo vetëm si dëshmi por pikërisht si motivim për përpilimin dhe mendimin e kaheve që duhet të merren kah konsolidimi i gjendjeve. Libri i bardhë, duhet të jetë një farë lloj nxitjeje edhe për debat, por edhe për veprim konkret. Në këtë drejtim, nëse alarmi i ndezur prek së paku në ca pjesë periferike të vetëdijes shoqërore aktive, atëherë do të jenë të paevitueshme edhe rezultate të caktuara. Dhe atëherë, vetëm atëherë, do të konsiderojmë se paraqitja e saj e ka arritur qëllimin e vet.

Tani, duke e pasur para vetes këtë publikim, redaktori është i gatshëm tu shprehë mirënjohje kolegëve dhe participantëve të vetë në këtë projekt: Ljubomir Kostovski, Biljana Bogdanovska, Kristina Ozimec, Illço Cvetanovski, Sashka Cvetkovska dhe Frosina Dimeska, mandej ekipit profesional të agjencisë “M-prospekt”, Dimitar Aspasiëv për komentet juridike, kryetares së LSGM Tamara Çausidis për involvimin e saj të tërësishëm në përpilimin e publikimit, si edhe të gjithë të tjerëve të cilët me punën e vet, me këshillat dhe njohuritë, ndihmuan në mënyrë të pashtershme në publikimin e Librit të bardhë. Së këndejmi, të gjitha dobësitë e mundshme të këtij punimi, duhet t'i përshkruhen ekskluzivisht vetëm redaktorit.

Xvezdan Georgievski

Libri i bardhë



Rasti i Biljana Jovanovska dhe kolegëve të saj kundër MPM

Rasti me aktvendimet për lëshim prej pune kundër një grupi të gazetarëve të "Utrinski vesnik", nga mesi i vitit 2011, e shqyrton pozitën e gazetarit në sistemin tonë juridik në aspektin kur ai fillimisht është ballafaquar me padrejtësinë në shtëpinë gazetare amë të veten, e cila si strumbullar i fuqishëm në hapësirën informative, gjen mënyra për ta pamundësuar sundimin e të drejtës edhe në sferën e marrëdhënieve të punës, aty ku është prekur pozita e gazetarit.

Në vështrim të parë, ky është vetëm një kontest i rëndomtë ndërmjet punëdhënësit dhe punëtorit (gazetarit). Por, për shkak të interesit që e nxit edhe përfshirjen e shumë faktorëve në procesin e mbrojtjes së gazetarëve, ai ngjan si një model nëpër të cilin mund të observohet pozita e gazetarit në vendin në përgjithësi.

Rasti me gazetaren Biljana Jovanovska, si edhe katër kolegët e saj - Katica Çangova, Olivera Vojnovska, Farko Sha-

qiri dhe Tamara Grnçarovska, është shembull për atë se si shteti juridik, "mbet pa frymë" ashtu siç shkohet kah format më të larta të mbrojtjes juridike të të drejtave të punëtorit, por edhe mbrojtja e një pjese të të drejtave dhe lirive të garantuara për çdo shoqëri demokratike.

Njëkohësisht, në këtë rast i cili ishte i pranishëm në opinion, u dërgua mesazh i qartë për atë se si do të kalojnë të gjithë ato që do të tentojnë ta shprehin të drejtën e vet për ta shprehur pakënaqësinë punëtore në proteste dhe në përpjekjet e tyre për ruajtjen e vendeve të tyre të punës.

PUSHIMET
E LEHTA NGA
PUNA
NUK HASIN
NË TRAJTIM
PËRKATËS NË
SISTEMIN
JURIDIK

Tubim spontan

Gjatë vitit 2011, në kompaninë MPM, pjesë e koncernit internacional Vest Algemajne Cajtung (VAC), bëhen përgatitje për racionalizimin e numrit të të punësuarve. Nëpër takimet formale dhe joformale të të punësuarve në "Utrinski Vesnik", një nga tre gazetatat ditore që i boton kjo kompani, flitet për pushimet më të mëdha nga puna, në raport me numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Një ditë pas datëlindjes së 12-të të gazetës, më 24 qershor 2011, është paralajmëruar ardhja e një ekipi nga menaxhmenti i kompanisë në redaksi, që duhet në mënyrë jozyrtare t'i prezantojë masat e veta për racionalizimin e kuadrit. Gazetarët të cilët marrin vesh për këtë, atë ditë, i thirrin edhe kolegët e vet që për momentin mungojnë (janë në shfrytëzim të pushimit vjetor, të ditëve të lira), me qëllim që së bashku ta dëgjojnë vendimin e fantit të tyre. Ndërsa, pas njohurive konkrete të një pjese të atyre fakteve, shprehin pakënaqësi spontane, që shndërrohet në kërkesë për mbajtjen e një konference për shtypin për informimin e opinionit me situatën.

Me marrëveshje ndërmjet gazetarëve të pranishëm, ajo që është me moshë më të madhe ndër to - Biljana Jovanovska, u drejtohet gazetarëve të ardhur dhe i shpalos vendimet e udhëheqësi së kompanisë, që paraprakisht vetëm janë paralajmëruar - planifikohen së paku dhjetë (mundet edhe më shumë) pushime nga puna, prej 47 të punësuarve.

Në fjalimin shprehet droja se paralajmërimet për pushimin nga puna e një të pestës të të punësuarve janë vetëm një hap kah shuarja graduale e gazetës ditore. Njëkohësisht thuhet se pagat e tyre, që lëvizin prej 200 deri në 400 euro, nuk do i përmirësojnë rrethanat financiare në redaksi. Me këtë rast, është vërejtur se atje për momentin mungon kuadër. Kërkohet të organizohet takim mes udhëheqësish së MPM dhe sindikatës së redaksisë, ndërsa si trysni e mundshme për opsionin e tillë propozohet edhe ndalimi i punës dhe modalja e gazetës ditën e ardhshme.

Kompania, ditën e njëjtë, (24 qershor 2011), lëshon njoftim në të cilin takimi interpretohet si "akt i vullnetarizmit të individëve" dhe si "tentativë për çrregullimin e disiplinës së punës". Konferenca për shtyp vlerësohet si thirrje nga persona të paautorizuar kurse të dhënat e shpalosura si jopërkatese me politikën e vërtetë të firmës.

Gazeta del ditën e ardhshme me numër të zvogëluar të faqeve. Shtojcat reklamuese nuk janë shkurtuar dhe në këtë aspekt nuk ka dëm material. Botimin e përpilojnë kryeredaktorja

dhe disa redaktorë të rubrikave, të cilët nuk pajtohen me ndërprerjen, në bazë të materialeve ekzistuese që janë veç më të arkivuara, por janë vepër edhe e punëtorëve të cilët kanë paralajmëruar ndërprerje spontane të punës.

Tre ditë pas ngjarjes, përfaqësues të Sindikatës së pavarur të gazetarëve dhe punëtorë të mediumit, të sindikatës së “Utrinski vesnik” dhe të udhëheqësisë së MPM, mbajnë një takim në lidhje me ngjarjet në “Utrinski vesnik”, që kanë të bëjnë me paralajmërimet për reduktimin e vendeve të punës që solli deri në ndërprerjen spontane të punës.

Në takim, Sindikata e ka prezantuar qëndrimin e shumicës së anëtarëve në “Utrinski vesnik” të cilët nuk i pranojnë paralajmërimet për pushime nga puna dhe kërkojnë negociata për gjetjen e zgjedhjes tjetër. Njëkohësisht, LSGM informon se, edhe pse nuk ka qenë e informuar për ndërprerjen e punës, për shkak se kjo ka ndodhur në mënyrë spontane, qëndron tërësisht prapa shumicës së anëtarëve të kolektivit të cilët kanë marrë pjesë në ngjarjet.

Duke e marrë parasysh logjikën e tregut, udhëheqësia e MPM i ka ofruar sindikatës propozim për zvogëlimin e shpenzimeve, gjë që nuk do të përfshijë aktvendime për pushim nga puna. Ky propozim u është prezantuar të punësuarve dhe udhëheqësisë së “Utrinski

vesnik” dhe është pranuar, por për shkak të asaj që vijonte, kurrë nuk është realizuar.

Aktvendime ekspres për përjashtim nga puna

Tre ditë pas marrëveshjes ndërmjet Sindikatës dhe menaxhmentit të “Utrinski”, pasi të punësuarës Jovanovska i është njoftuar gojarisht se është suspenduar, kurse tekstet e saj nuk botohen, menaxhuesi i i “Krug” SHPK, që është pjesë e VAC- Srgjan Kerim, nënshkruan Vendim për pushimin e marrëdhënies së saj të punës për shkak të cenimit të rendit të punës, të disiplinës dhe të obligimeve të punës, pa afat për largim nga puna. Largim nga puna merr edhe gazetari Farko Shaqiri, i cili ditën e theksuar aspak nuk ka qenë as në punë, por paska ardhur për tu informuar për qëllimet e menaxhmentit dhe paska qenë aktiv në marrjen e vendimit për ndërprerje spontane të punës.

Në Vendimin për largimin nga puna 1 prej m 1 korrik 2011,

NJË DITË PAS
DATËLINDJES SË
12-TË TË GAZETËS,
ËSHTË PARALAJMËRUAR
ARDHJA E EKIPIT
NGAN MENAXHMENTI,
I CILI DUHET
TË PREZANTOJË
MASA PËR
RACIONALIZIM

punëdhënësi thirret në nenet 82, paragrafi 1 dhe paragrafi 239, pika e LMP, neni 47 i Rregullores për marrëdhënie të punës dhe Rregullores për rend dhe disiplinë në “Krug” SHPK (pjesë e VAC ku bëjnë pjesë vetëm gazetatat ditore “Utrinski” dhe “Dnevnik”).

Shkurtimisht, menaxhuesi, pohon se ndërprerja e punës ka për qëllim – mosdalje të gazetës dhe se prapa tij qëndron organizatë me disa gazetarë. Gjithashtu, nënvizohet se prapa protestës nuk qëndron organizata sindikale dhe kryeredaktorja.

Reaksioni sindikal

Lajmi për largimet nga puna në “Utrinski” i ngriti në këmbë organizatat gazetarë. LSGM dhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë, solidarizohen fuqishëm me kolegët prej “Utrinski vesnik” të cilët e kundërshtojnë qëllimin e menaxhmentit të MPM për të larguar nga puna gazetarë si dënim për shprehjen e pakënaqësisë punëtore.

SHGM e mbështet aksionin e LSGM për solidarizimin me kolegët e “Utrinski vesnik”, me anë të nënshkrimit të deklaratës për përkrahje dhe e thëret anëtarësinë e vet që ti bashkëngitet aksionit në mënyrë masovike.

Të nxitur nga këto largime nga puna, por edhe nga gjendja e përgjithshme në të cilën punojnë gazetarët, mbyllja e ca medimeve, TV A1, “Vreme”, “Shpic” dhe “Koha e re”, më 5 korrik të vitit 2011, gazetarët, ato me honorarë, fotoreporterët, incizuesit dhe kuadrot teknikë e të gjithë medimeve në Maqedoni, qëndruan në mbrojtje të të drejtave të vtyre të punës, dhe mbajtën një marsh protestues nëpër qendrën e qytetit, deri në Sheshin Maqedoni.

Organizatorët e protestës ishin Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punëtorëve të Mediumit të Maqedonisë dhe Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Gazetarët, në protestë kërkuan prej punëdhënësve ta njohin sindikatën si partner real në dialogun social dhe mos lejohet që puna gazetarë të trajtohet si mjet për përmbushjen e interesave personale të biznesit ose të politikës.

Ditën e njëjtë, në reaksionin që vjen prej sindikatës gjermane VER.di, jepet përkrahje për luftën e gazetarëve maqedonas për të drejtat e tyre. Kërkohet prej bordit në Germani dhe në Maqedoni, “në Maqedoni të sillen në përputhje me standardet gjermane të civilizimit dhe korrektësisë”. Largimet nga puna vlerësohen si “të papërshtatshme dhe jopërkatese” dhe kërkohet që punëtorët të kthehen në vendet e punës, ndërsa në të ardhmen, të gjitha biznes planet dhe veprimet afariste të jenë transparente, në kohë dhe të miratohen në relacion me sindikatën.

Dhe, çka ndodh pas kësaj – një pjesë e gazetarëve të “Utrinski vesnik” të cilët kanë marrë pjesë në protesta, marrin aktvendime për largim nga puna në byrotë e punës. Numri i personave me aktvendime për largim nga puna, edhe përsëri marrëveshjes së ashtuquajtur me Sindikatën, u tregua thjesht si e rrejshme. Në atë çast MPM e prezanton veten si kompani e cila nuk pranon dialog social me partnerë relevantë siç janë organizata sindikale e kolektivitet dhe sindikata e degës në nivel të vendit.

LSGM lëshon njoftim ku shkruan se “në çastin kur qindra gazetarë ishin në protestë, përveç tjerash, edhe për tu dhënë përkrahje dhe të tregojnë solidaritetet me dy koleget të cilat të premtën, në mënyrë ekspres i humbën vendet e tyre të punës, MPM u përgjigj me largime të reja nga puna. Për këtë shkak, nuk na mbet asgjë tjetër përveç se të konstatojmë moral të dyfishtë të kompanisë e cila e para e filloi dialogun me Sindikatën, ndërsa tani për ta braktisur, duke i shkatërruar relacionet e korrektësisë. Largimet nga puna për kolegët tonë nuk do na demoralizojnë, dhe nuk do të lejojmë të shkatërrohet aktivizimi sindikal që në fillimin e lindjes së vet.”

NJË PJESE E
GAZETARËVE
TË "UTRINSKI
VESNIK" QË
KANË MARRË
PJESE NË
PROTESTA
FITOJNË
AKTVENDIME
PUSHIMI
NGA PUNA NË
TRYEZAT E PUNËS

Procedura juridike

Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve të “Utrinski vesnik”, pesë të parët që ju dhanë largim nga puna prej duzina që u larguan nga kompania, vazhdon të rrjedhë në linjë të kontesteve juridike.

Më 18 korrik të vitit 2011 година, Inspektorati Shtetëror i Punës lëshon njoftim në të cilin shkruan se ka pranuar pesë kërkesa me shkrim për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës në “Krug” SHPKPV (Olivera Vojnovska, Tamara Grnçarovska, Biljana Jovanovska, Farko Shaqiri dhe Katica Çanogova), se ka kryer mbikëqyrje inspektuese dhe ka konstatuar se të punësuarit, në përputhje me LMP, nuk mund të largohen nga puna pa afat për largim nga puna. Për këtë arsye, inspektorati i punës merr aktvendim me të cilin i jepet urdhër punëdhënësit të marrë aktvendim për anulimin e vendimeve për pushim të marrëdhënies së punës pa afat për largim nga puna. Aktvendimi me numër (07 - 1443), duhet të zbatohet menjëherë. Ky aktvendim, në një arsyetim të hollësishëm, mbështetet në bazë të asaj që

bazat që janë theksuar për largimet nga puna, nuk mund të kenë për prodhim – largim nga puna pa afat për largim .

Në një pjesë të procedurave gjyqësore është e qartë se që në start peshon më shumë besimi gjyqësor i lirë dhe se asnjë nga mendimet e aktorëve në atë proces pune (inspektorët e punës, organizatat sindikale – ajo amë dhe LSGM) nuk janë marrë si relevante, ashtu që gazetaret Olivera Vojnovska, Katica Çangova dhe Tamara Grnçarovska i humbin proceset në Gjykatën Themelore dhe në atë të Apelit dhe momentalisht janë para Gjykatës Supreme.

Gjykatat, në një mënyrë të pashpjegueshme nuk i përqendrohen procedurës e cila doemos të ekzistojë gjatë dhënies së aktvendimeve për pushimin e marrëdhënies së punës që nënkupton se nuk është i mundur largimi nga puna pa procedurë disiplinore dhe ky rregull është pa përjashtime.

Kthesa ndodh në fund të vitit të kaluar dhe fillimin e këtij viti.

Respektivisht, gazetari Farko Shaqiri, këto ditë është kthyer në kompani dhe i është ofruar vend pune por në medium tjetër, pasi që padia e tij është pranuar dhe bëhet e plotfuqishme.

Me aktgjykim të Gjykatës Themelore të pranuar më 17 janar të këtij viti, a të miratuar më 31 dhjetor vitin e kaluar, është abroguar si i pa bazë vendimi për pushimin e marrëdhënies së punës edhe i gazetares Biljana Jovanovska.

Kjo, në shikim të parë mund të kuptohet si finale e drejtësisë dhe e shtetit juridik, por në rast se nuk bëhej fjalë për trajtim të ndryshëm të rasteve të njëjtë, me dëshmitarë identikë dhe me fakte identike, edhe atë jo nga gjykatës të ndryshëm por edhe nga gjykatës i njëjtë

që i gjykon paditë e Jovanovskës dhe Çangovskës.

Gjegjësisht, gjykatësi i njëjtë ka konkluduar se zbatimi i nenit 293, pika 3 e LMP në rastin e Jovanovskës nuk ka bazë, për shkak se nuk janë përmbushur kushtet për të dorëzuar aktvendim për largim nga puna pa afat ligjor, ndërsa, në rastin e Çangovskës, gjykon ndryshe.

Përfaqësues të Komitetit të Helsinkit ishin të pranishëm gjatë gjykimit të gazetarëve. Cenimi më i rëndësishëm i të drejtave të gazetarëve është që u cenohet e drejta e garantuar me ligj që procesi i punës të përfundojë për gjashtë muaj. Por, zgjidhja gjyqësore për njërën nga paditëset pritej dy vite e gjysmë pas filimit të proceseve gjyqësore.

- Në lidhje me këtë të drejtë, të drejtën për gjykim me prioritet dhe të shpejtë, është edhe e drejta në punë dhe të drejta të tjera të afërme. Ato janë në lidhje me ekzistencën e familjeve dhe nuk lejohen në praktikën gjyqësore, për arsye se ligjvënës[si jo rastësisht është përcaktuar për afatet që janë të njohur (deri në gjashtë muaj) - thonë nga komiteti i Helsinkit.

Sipas kësaj, kjo organizatë e përkushtuar ndaj promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me atë që gazetarët janë përjashtuar nga puna drejtpërdrejt pas shprehjes së pakënaqësisë, bëhet një goditje mbi të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit, e veprimi sindikal dhe tjetër, veçanërisht kur u është rrezikuar e drejta themelore ekzistenciale.

Rezyme

Edhe pse proceset gjyqësore nuk janë përfunduar, nga tentativa e deritanishme e grupit të gazetarëve nga "Utrinski vesnik" për tu mbrojtur nga largimet nga puna që u janë dorëzuar, dhe e një sërë organizatave dhe institucioneve të inkuadruara në këtë kontest pune, mund të merret përfundimi në vijim:

MPM, SI PJESË, NË
ATË KOHË, E NJË
KOMPANIE
BOTËRORE, E
LËSHON RAŠTIN TI
BARTË BOTËKUPTIMET
BASHKËKOHORE
PARTNERE PËR
RELACIONET
NDËRMJET
UDHËHEQJES
KORPORATIVE
DHE PUNËTORËVE

Së pari, kompania më e madhe në sferën e medimeve të shtypura në Maqedoni - MPM, si pjesë, në atë kohë, e një kompanie botërore në atë fushë, e lëshoi mundësinë t'i bartë në truallin tonë botëkuptimet bashkëkohore, partnere për relacionet ndërmjet udhëheqësisë korporatave dhe punëtorëve. Dhe, kur bën përpjekje të fillojë dialog ndërmjet sindikatës dhe punëdhënësit, në bazë të tepricës teknologjike dhe vihet deri në një zgjidhje fillestare, marrëveshja prishet dhe vazhdohet me politikën e vjetër të zbatimit të "fuqisë së vrazhdë".

Mandej, miratohet model për racionalizim pa pjesëmarrjen e të punësuarve. Ai miratohet me elemente kuantifikuese të panjohura, as që dihen qëllimet e fundit të të ash.q. "racionalizim". Respektivisht, në "Utrinski vesnik", me aktvendimet për largim nga puna të lartpërmendura, a edhe mandej, janë mënjeluar ose po janë larguar një duzinë të punësuar por ama mandej atje transferohen të punësuar nga redaksi tjera (nga "Dnevnik"). Në ndërkohë, në kuadër të këtij botuesi u themeluan edhe botime tjera ku mund të transferohej "teprica" e kualifikuar për punën e vet por, u pranuan gazetarë tërësisht të ri, me konkurs. Kjo e hap dyshimin se MPM, në gazetarët e vet shikon si punëtorë të "përshtatshëm" dhe "më pak të përshtatshëm" dhe se pas racionalizimit në fakt mundet qëndrojnë edhe motive tjera.

Së këndejmi edhe pohimet e Sindikatës se procedurat e këtilla ndaj të punësuarve që e kanë marrë guximin ta demonstrojnë pakënaqësinë, detyrimisht janë dizajnuar që tu shtihet frikë te gazetarët dhe të ndikohet në organizimin e tyre sindikal dhe çfarëdo lloji tjetër i organizimit profesional.

Me futjen e frikës, me moslejimin e shprehjes së mendimit personal në vetë kompaninë, ndikohet mbi to edhe si mbi krijesa kreative dhe të lira në raport me të gjitha çështjet shoqërore me të cilat ballafaqohen dhe për të cilat duhet të informojnë ose po të komentojnë!

Solidariteti i pamjaftueshëm ndër vetë gazetarët, gjithsesi se është çështje që imponohet edhe në këtë rast, si edhe çështja e interesit të dobët për organizim sindikal, që është një trend botëror me decenie, por edhe udhërrëfyes i keq për kërkimin e të drejtave të punës të gazetarëve, prej të cilëve pritet të kenë vetëdije më të lartë për vetorganizim në institucionet legale të sistemit.

Pyetja e sjelljes së një pjese të institucioneve (Gjykata Administrative, pjesë e gjykatave të rregullta) sugjeron se gjykohet nën impresiono, pa mbështetjen e vendimeve mbi të drejtën materiale dhe se ekziston diskrapancë e palejuar gjatë vendimarrjes ndërmjet institucioneve të njëjta ose po të ngjashme (organe inspektuese - Gjykata Administrative), ose po ndërmjet vetë gjykatësve në gjykatat e njëjta.

Ljubomir Kostovski

Suspendimet revanshiste dhe Largimet ekspres nga puna, si "masa shtrajkbrehere" malicioze, të drejtuara kah ato të punësuar të cilët janë më pak rebelë nga të tjerët dhe duan që në mënyrë spontane ta shprehin revoltën e vet, janë nga ato më me stres në praktikën juridike-të punës. Kjo në anën tjetër, e hap problemin esencial të të drejtës sonë bashkëkohore të punës - dhe kjo është mundësimi i realizimit të të drejtës kushtetuese në grevë, si masë e fundit, juridike-natyrore dhe legjitime për mbrojtjen e të drejtave punëtore. Ndërsa nga këndvështrimi ligjor, në drejtim të bazave jopopullore të largimit nga puna - me ose pa afat për largim nga puna - ose, siç është definuar kjo në LMP, "mënyrat e pushimit të vlefshmërisë së marrëveshjes për punësim", në periudhën e tranzitimit dy deceniesh erdhi deri në zvogëlimin thelbësor dhe shqetësues të të drejtave të punëtorëve! Punëdhënësit, këto metoda drakonike dhe të pamëshirshme të dhënies së shpejtë të "largimit disiplinor nga puna", më së shpeshti i shfrytëzojnë kur të hasin në rezistencë të organizuar nga ana e punëtorëve, pa dallim nëse ato janë ose po nuk janë të organizuar në mënyrë sindikale, kurse gjyqësia dështoi tërësisht në realizimin e rolit të vet mbrojtës, veçanërisht në këto raste kur kemi paralajmërime tërësisht keqdashëse, të paarsyeshme, tendencioze dhe kundërligjore për largime masovike nga puna ose po shpalljes së tepricës teknologjike të më shumë gazetarëve nga shtëpi të ndryshme të medimeve, të cilët kanë marrë guximin të flasin publikisht për problemet në redaksinë e tyre ose po për trysnitë në të cilat janë eksponuar nga ana e redaktorëve dhe menaxherëve të tyre. Gjegjësisht, me anë të ndërhyrjes së doktrinave neoliberalë në sferën e legjislacionit të punës, është shumë e dukshme tendenca shtetërore e destimulimit të shfrytëzimit të kësaj të drejte kolektive kyçe e të punësuarve, si

KOMENT JURIDIK

metodë e drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kështu, përmes serisë së ndryshimeve dhe plotësimeve tepër të shpeshta të Ligjit për marrëdhëniet e punës, u vendosën një sërë masash represive që kishin tendencë ta dekurajojnë grevën, bile edhe me çmim të kundërkushtetueshmërisë - duke e ngarkuar me një sërë procedura burokratike, të cilat duhet të përfundohen para se të fillojë greva legjitime (për shembull: në rolin e organizatorit të ligjshëm të grevës mund të paraqitet vetëm sindikata; është vendosur obligimi për përpjekje paraprake për mbajtjen e procedurës së pajtimit me punëdhënësin; është vendosur mundësia për pagimin e kompensimit për dëm eventual që do i shkaktohej punëdhënësit, me çrast rrënohet kuptimi i vetë institucionit grevë; është vendosur një listë enorme e të ash.q. punëve prodhuese-mirëmbajtëse dhe të domosdoshme që nuk guxojnë të ndërpriten gjatë grevës; janë zvogëluar të drejtat nga marrëdhënia e punës gjatë grevës; janë vendosur një sërë dispozita kundërvajtëse kundër grevistëve "të padisiplinuar" etj.) Tejkalimi i këtij problemi të locuar enorm, në të ardhmen do të duhet patjetër të zhvillohet nëpërmjet një lloji të derregullimit dhe "relaksimit" ligjor në këtë materie kyçe, për arsye se ajo tani është e ngufatur nga normimi juridik i tepruar, që de facto e pamundëson realizimin e të drejtës në grevë në praktikë.



Litar i shkurtër për gazetarët

Dje - pagë e rritur si shpërblim për punëtor të mirë, sot - pushim nga puna. Në mëngjes në ngjarje si gazetar, në drekë - mbet pa punë. Shok të këtillë përjetoi në fund të vitit të kaluar një gazetarë e punësuar në një televizion. Ajo është rasti i fundit në pushimin e të cilës nga puna qëndron arsyetimi "arsye afariste" - formulim të cilin e lejon ligji ndërsa pronarët e (keq)përdorin disa vite prapa në mënyrë masovike me qëllim që të lirohen nga gazetarët të cilët pushteti, pronarët ose po redaktorët i konsiderojnë si "të përshtatshëm".

ME KONTRATAT NË
KOHË TË ÇAKTUAR
GAZETARËT
MBAHEN NË
PASIGURI,
TREMBEN SE
LEHTË MUND
TË MBEJN
PA PUNË

Ky është shembull drastik i largimit nga puna pa asnjë paralajmërim, pa faj konkret të punëtorit dhe pa arsyetim të argumentuar nga ane e punëdhënësit. Gazetarja, për disa orë mbeti pa punë, dhe akoma askush nuk i tregon se çka dhe kujt në fakt i ka gabuar. Veçanërisht për shkak se para pushimit nga puna, nuk ka pasur asnjë problem që do të paralajmëronte një veprim të këtillë të punëdhënësit.

- Kontratat për punë ishin në kohëzgjatje prej tre muajsh dhe vazhdimisht na i vazhdonin. Kontratën e fundit e nënshkrova më 8 nëntor të vitit 2013, gjithashtu para tre muajsh. Para se të nënshkruaj, pranova edhe një letër shoqëruese nga punëdhënësit se janë të kënaqur nga puna ime dhe se duan ta vazhdojnë kontratën. Më 11.12.2013, e pranua pagën e nëntorit me të cilën unë dhe disa kolegë pranua rritje prej një mijë denarë, për shkak të kryerjes së mirë të detyrave të punës. Vetëm një ditë më vonë, më 12.12.2013, drejtori programor i televizionit më informoi se e kanë informuar nga punëdhënësit se ka aktvendim për ndër-

prejzen e marrëdhënies së punës - dëshmon gazetarja.

Në këtë rast, punëdhënësi nuk ka pritur të skadojë as kontrata e nënshkruar me afat deri në shkurt të këtij viti. Në shpejtimin për ta larguar nga puna, ka bërë gabime në procedurë - një ndër gabimet është ai që në vend që personalisht t'ia dorëzojë letrën për pushim nga puna, ai e ka dërguar me anë të postës.

- Isha e habitur dhe e çuditur, edhe aq më shumë për shkak se udhëheqësit e mi të drejtpërdrejtë, drejtori programor dhe redaktori kryesor dhe përgjegjës, nuk ishin në gjendje të mi tregojnë arsyet për pushimin nga puna. Njëllor si edhe drejtuesi i firmës i cili e ka nënshkruar aktvendimin. Aktvendimin ma kishin dërguar me anë të postës, në adresën shtëpiake, ndërsa unë kërkoja ta dërgojnë edhe në e-adresën time. Tek atëherë lexova se bëhet fjalë për pushim nga puna të cilin firma e arsyeton me arsye afariste dhe vëllim të zvogëluar të punës të punëdhënësit - thotë ajo.

Kjo gazetarë ka pas vetes dhjetë vite përvojë pune. Ishte pjesë e ekipit që e startonte televizionin para tre viteve. Fillimisht ishte në pozitën e redaktorit të lajmeve. Pasi që në korrik të vitit 2011 disa gazetarë ishin pushuar nga puna, atë e ndërruan nga funksioni dhe i dhanë vetëm detyra gazetarë. Por, nuk kishte kritika për punën e saj. - - Pushimi nga puna ishte momental, pa afat për largim nga puna. Mua më gjeti të papërgatitur për shkak se asgjë nuk më përgatiti për një gjë të këtillë. Mëngjesin e njëjtë isha në një ngjarje dhe aspak nuk pritja që vetëm ca orë më vonë do të mbes pa punë. Puna e parë që më shkoi ndërmend ishte se mundet ka ndonjë arsye tjetër në prapavijë. Por, askush nuk dëshironte ose po nuk mundej të më shpjegojë se cila është ajo. Akoma nuk besoj se pushimi nga puna ishte për arsye ekonomike. Nuk kam mënyrë se si ta provoj këtë dhe të zbuloj se çka në fakt ndodhi - tregon ajo.

Është e hutuar nga formulimi “arsye afariste”, për shkak se nuk ka pasur asnjë tregues për krizë në firmë, - përkundrazi, në raport me fillimin, vëllimi i punës është zmadhuar vazhdimisht, fillohej me edicione të reja të lajmeve kurse hyrjet nga reklamat kanë qenë në rritje.

Na mbajnë në pasiguri, na trembin dhe na kontrollojnë

Ky shembull e pasqyron pasigurinë profesionale me të cilën ballafaqohen numri më i madh i gazetarëve në mediumet maqedonase – çdo ditë punojnë dhe jetojnë me mundësinë që pikërisht ajo ditë mund të jetë dita e fundit në punë. Sado i madh të jetë problemi që do e rrezikojë ekzistimin personal ose po të familjes, edhe më e tmerrshme është ajo që kur do të kalojnë muaj e muaj derisa përsëri të punësohen si gazetarë – nëse gjejnë punë.

Në mediumet kryesisht mbisundojnë kontratat për punë në kohë

të caktuar. Më së shpeshti, këto janë kontrata për një muaj, tre ose po gjashtë muaj. Natalija Radivojeviq Milenkova, avokate e cila i përfaqëson gazetarët nëpërmjet Sindikatës së pavarur të gazetarëve dhe punëtorëve të mediumit, thotë se gjendja e këtillë është prej vitit 2010-2011, prej kur edhe filloi largimi masovik nga puna i gazetarëve “të papërshtatshëm”.

- Konsideroj se në përgjithësi tendenca e punëdhënësit është ta lehtësojë mënyrën e largimit nga çuna të punëtorëve, ndërsa kontrata në kohë të caktuar është mënyra më elegante për këtë. Jemi dëshmitarë se gjithnjë e më shumë vendimin për atë se a duhet ose nuk duhet një gazetar të mbesë në ndonjë medium merret më shumë jashtë sesa prej vetë punëdhënësit të drejtpërdrejtë. Në

rrethana të atilla, kontrata në kohë të caktuar është mënyra më e lehtë për punëdhënësin të sigurohet në rastet kur nuk ekziston arsye reale për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Lehtë do e ndërpresë kontratën për shkak të skadimit të afatit për të cilin edhe është lidhur kontrata. Për këtë shkak, punëtorët, kur nënshkruajnë kontratë në kohë të caktuar, duhet të jenë të vetëdijshëm se marrëdhënia e punës do të zgjasë aq kohë për sa edhe është lidhur kontrata – thotë Radivojeviq Milenkova.

Ato të cilët kanë kontrata për një vit, mund ta llogarisin veten si të lumtur. Ka edhe kontrata në kohë të pacaktuar por, sipas përvojave nga redaksitë, ato janë

minimale në krahasim me ato në kohë të caktuar.

Me ato kontrata të shkurta për nga disa muaj, gazetarët nuk ndihen aspak të mbrojtur me ligjet. Kjo vlen edhe për rastet kur kontrata është akoma në fuqi, si në rastin e lartpërmendur. Edhe ato kontrata, me periudhë akoma të pa skaduar sipas kontratës, pronari mund t'i ndërpresë për një çast. Mjafton vetëm të theksohet se kjo bëhet për arsye afariste. Me këtë, respektohet Ligji për marrëdhëniet e punës, kurse as gjykata nuk do të kërkojë prej tij ta provojë arsyeshmërinë e veprimit.

- Me mediumin kam kontratë për punë për tre muaj. Deri tani, vazhdohet disa herë, por pa qëllim të qartë për ta ndryshuar në kontratë shumëvjeçare. Kjo, mua më jep disa sinjale. Se duan të na mbanjnë në pasiguri, të na trembin se mundemi lehtë të mbesim pa punë, në kushte kur edhe ashtu ka shumë gazetarë të papunësuar. Kam përshtypjen se kjo është për shkak të dëshirës ta kontrollojnë atë që ne e shkruajmë, me mesazh se në rast se diçka nuk është në interesin e tyre, munden lehtë të lirohen prej nesh dhe të na zëvendësojnë me

TENDENCA E
PUNËDHËNËSIT
ËSHTË TA LEHTËSOJË
MËNYRËN E PUSHIMIT
TË PUNËTORËVE NGA
PUNA, KURSE
KONTRATANË KOHË TË
CAKTUAR ËSHTË
MËNYRA MË ELEGANTE
PËR KËTË

për padrejtësitë e veta edhe për padrejtësitë e të tjerëve. Kështu, për shkak të lehtësisë me të cilën humbet puna, ka redaksi ku gazetarët shumë shpesh dënohen me para në rast se sjellja e tyre ose po puna e tyre në çfarëdo mënyre nuk i pëlqen kuadrin udhëheqës. Edhe pse ligji kërkon që dënimet me para të arsyetohen me shkrim, me këshill juridik dhe të drejtë në kundërshtim, shumë kolegë as që pyesin se pse janë dënuar në rrogë.

"Te ne në redaksi, për atë se je dënuar për diçka do të marrësh vesh pasi ta marrish letrën e rrogës. Deri më tani askush nuk ka kundërshtuar, as që ka kërkuar arsyetim për shkak të frikës së mund të jetë edhe më keq", na tha një kolege më e moshuar.

NËSE KUNDËRSHTONI,
ÇDOHERË ËSHTË ATY
MESAZHI SE TRE
MUAJT DO TË
PËRFUNDOJNË
SHPEJT, NDËRSA
HERËN TJETËR
KONTRATA NUK
DO TË VAZHDOHET
DHE JU PËRSËRI
DO U
BASHKËNGJITENI
KOLEGËVE NË RRUGË

Inspektorët e punës as nuk hynë nëpër medime

Edhe përsikaj asaj që kontratat në kohë të caktuar janë rruga më e shkurtër nëpër të cilën punëtori mund të mbesë pa punë, sikur edhe kjo nuk u mjafton punëdhënësve por bëjnë shpërdorime për ta lehtësuar largimin nga puna në mënyrë plotësuese dhe t'i zvogëlojnë obligimet e tyre ndaj të punësuarve. Ka raste të këtilla: nëse kontrata është lidhur në kohë të caktuar prej një viti, e njëjta, në vend që të vazhdohet me aneks për kohën e njëjtë, ajo nuk vazhdohet por punëtori vazhdon të punojë në mënyrë faktike kurse punëdhënësi e paraqit në Agjencinë e Punësimit për më pak muaj. Në këtë mënyrë, siguron për vete kushte më të lehta për ndërpre-

rjen e marrëdhënies së punës të punëtorit. Kjo u bë e mundur pasi që Agjencia e Punësimit morri vendim të mos kërkojë të parashtrihen edhe kontratat prej të cilave do të mund të shihej edhe vullneti i punëtorëve.

Inspektorët e punës, vitin e kaluar nuk kanë hyrë në asnjë medium për të përcaktuar nëse gazetarët pranojnë kontrata për punë të përcaktuar me ligj ose po pronarët e cenojnë Ligjin për marrëdhëniet e punës. Kanë proceduar vetëm për cenimin e të drejtave të punëtorëve në portalin komunikacija.mk, pronari i të cilit ishte dënuar për mashtrim. Inspektorët kanë konstatuar se ai i mashtruaka gazetarët e portalit dhe nuk u dhënka pagë. Në raportet vjetore të publikuara në faqen e internetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës, (i fundit është për nëntor të vitit 2013), shihet se inspektorët e punës kanë kryer gjithsej 2.950 mbikëqyrje inspektuese nëpër firma të

ndryshme, por ndërmjet tyre nuk ka asnjë medium.

Fitoret e gazetarëve mbi punëdhënësit, të fituara në gjykatë janë të pakta në numër por, përsëri japin shpresë se drejtësia mund të jetë e kapshme. Në shërbimin juridik të Sindikatës së Gazetarëve ka shtatë reagime nga gazetarë me kontrata në kohë të caktuar. Janë regjistruar pesë konteste juridike prej të cilave tre janë raste të të punësuarve në një televizion kabllovik ku kontratat në kohë të pacaktuar ishin të shkarravitura dhe të prezantuara si kontrata në kohë të caktuar. Janë dy raste të të punësuarve në televizion me koncesion nacional të cilët kishin kontratë në kohë të caktuar në të cilat kontrata nuk ishte shënuar data kur janë lidhur, me ç'rast u konstatua cenim i drejtpërdrejtë i nenit 14, paragrafi 3 i Ligjit për marrëdhënie të punës. Në dy raste, punëtorëve ua ndërpresin marrëdhënien e punës në kohë të caktuar, në mënyrë të pabazë, para skadimit të afatit, por ato kanë vlerësuar se nuk u paguhet të zvarriten nëpër gjykata. Punëtorët e televizionit kabllovik i fituan kontestet, përveç për njërin për të cilin pritet që Gjykata e Apelit ta konfirmojë pjesën se punëtori duhet të kthehet në punë. Rastet e dy gazetarëve nga televizioni nacional përfunduan me marrëveshje jashtëgjyqësore me të cilën menaxhimi e pranoi pabazshmërinë dhe është paguar kompensim i dëmit.

Kolegja nga pjesa hyrëse e tekstit nuk do e padisë televizionin, edhe pse ka bazë për padi. Nuk ka llogari financiare, kurse vlerësimin që e ka bërë vetë, është vlerësimi që e bëjnë edhe gazetarë të tjerë kur për arsye e njëjtë heqin dorë nga kërkimi i drejtësisë.

Për shembull, nëse gazetari ka qenë i paraqitur në kohë të caktuar, kurse marrëdhënia e punës i ka pushuar dy muaj para se të skadojë kontrata, dhe me atë rast provon se largimi nga puna ka qenë i pabazë, kompensimi për dëmin që do e kishte marrë është në lartësi të fitimit të humbur për ato dy muaj. ndërsa, nëse e humb kontestin, harxhimet për procedurën që do të duhet t'i paguajë janë prej 25.000 denarë e sipër, deri në dy mijë euro për raste më të ndërlikuara. Dhe, nëse ka marrë honorar mbi çfarëdo baze, ai honorar hiqet nga dëmi. Në fund, del se ai si kompensim për dëmin do të fitojë një shumë me të vërtetë të vogël të parave ose po aspak nuk do të fitojë asgjë. Rrjedh se kontesti gjyqësor është vetëm për satisfaksion moral, për të provuar se është larguar nga puna në mënyrë të pabazë. Ironike por, punëdhënësi mbet bile edhe i shpërblyer, për shkak se nuk do të paguajë dëmshpërblim.

Pasiguri ekzistenciale

Sa alarmante është gjendja me kontratat në kohë të caktuar në mediumet, aq është e madhe edhe frika të flitet në këtë temë. Kjo shihet edhe nga fakti që të gjitha deklaratat janë anonime - edhe të

atyre që kanë mbetur pa punë por edhe të atyre që çdo ditë janë nën presionin se pronari mund të mos ua vazhdojë kontratën për punë.

Radiojeviq Milenkova këshillon që punëtorët të insistojnë në kontrata në kohë të pacaktuar.

- Këtu, më shumë mund të bëhet fjalë për pasiguri ekzistenciale sesa juridike por, punëtori me pranimin e kontratës në kohë të caktuar, pajtohet me këtë. Prandaj konsideroj se kur shkohet në negociata për punë, punëtorët duhet të këmbëngulin më shumë dhe ta detyrojnë punëdhënësin të lidhë kontratë në kohë të pacaktuar me to, e jo menjëherë të pajtohen me ofertën që ua jep punëdhënësi. Ashtu siç punëtori ka nevojë ta zgjidhë çështjen e vet ekzistenciale dhe të punësohet, ashtu edhe punëdhënësi ka nevojë për forcë

pune. Prandaj, punëtorët kur negociojnë për punë, duhet ta shohin veten si faktor relevant dhe të angazhohen që të lidhin kontrata në kohë të pacaktuar, me çka do të kenë siguri më të madhe - thotë ajo.

Ku dallojnë dy llojet e kontratave? Për kontratën në kohë të caktuar vlejnë dispozitat e njëjta të Ligjit për marrëdhënie pune si edhe për kontratën në kohë të pacaktuar (në drejtim të llojeve të largimeve nga puna), me atë dallim që kontrata në kohë të caktuar skadon edhe për shkak të skadimit të kohës për të cilën është lidhur. Punëdhënësit janë të kufizuar vetëm me afatin e fundit deri kur munden t'i vazhdojnë kontratat, e kjo është pesë vite. Më saktë, nëse punëtori ka pranuar kontrata në kohë të caktuar në periudhë

prej pesë vitesh, mandej në mënyrë automatike transformohet në kontratë në kohë të pacaktuar. Nëse kjo nuk ndodh, punëtori mund ta padisë punëdhënësin.

Mirëpo, edhe kjo dispozitë nuk është garanci e fortë, për shkak se është ashtu e shkruar që le hapësirë që secili ta interpretojë ashtu si i konvenon. Këtë e konstatuan edhe inspektorët e punës.

- Nuk ka mbrojtje ligjore për punëtorët në kohë të caktuar, përveç kësaj dispozite. Por, edhe kjo është hutuese dhe e dyshimtë. Për këtë arsye, jemi dëshmitarë të praktikës së ndryshme të punëdhënësve dhe të gjykatave. Për veprën e njëjtë, ka aktgjykime të ndryshme gjyqësore. As ne nuk jemi në të pastër se si ti këshillojmë punëtorët. Më së shpeshti i udhëzojmë të shkojnë në gjyq - thonë nga Inspektorati i Punës.

Sipas inspektorëve të punës, në sektorin privat, kontrata në kohë të caktuar më së shpeshti ka për punëtorët e ri, ato për të cilët nuk

AQ SA KA
PUNËTORI
NEVOJË TA
ZGJIDHË
ÇËSHTJEN E VET
EKZISTENCIALE
DHE TË
PUNËSOHET,
PO AQ KA EDHE
PUNËDHËNËSI
NEVOJË PËR
FUQI PUNE

janë të sigurt nëse do i mbajnë në punë. Në sektorin shtetëror, ato janë më së shpeshti në fushën e arsimit, prej ku pas 5 viteve transformohen në kontrata në kohë të pacaktuar.

Nga Konfederata e punëdhënësve thonë se është praktikë e kompanive që në afat të caktuar të punësojnë punëtorë sezonalë ose po punëtorë me orar të shkurtuar të punës. Të tjerët punësohen në kohë të pacaktuar. Sipas kësaj, rrjedh se kontratat me afat saktë të përcaktuar janë më së shumti në mediumet.

Vetëm mbrojtja kolektive mund ti kundërvihet punës së pasigurt

Në situatë kur është evidente tendenca e punëdhënësve që gjithnjë e më shumë punësimet ti definojnë në kohë të caktuar, kurse institucionet kompetente janë inerte ose po edhe vetë e përkrahin trendin me ndryshimet e Ligjit për marrëdhëniet e punës i cili vazhdimisht e zmadhon periudhën e lejuar për punësim në kohë të caktuar, punëtorëve të mediumit nuk u mbet asgjë tjetër përpos që të vetorganizohen.

Jo në mënyrë individuale por vetëm si grup i fuqishëm dhe solidar mund të bëhet presion mbi punëdhënësit për vazhdimin ose po zëvendësimin e kontratave prej në kohë të caktuar në kohë të pacaktuar.

Njëkohësisht, sindikatat janë ato të cilat mund të gjenerojnë edhe presion publik i cili do të sillte deri në ndryshimin e Ligjeve dhe afateve të lejuara për punë në kohë të caktuar. Rrezikun nga një presion i atillë si duket e njohin më shumë vetë punëdhënësit në krahasim me punëtorët ashtu që çfarëdo aktivitetesh me aspekt sindikal konsiderohen si jodisiplinë kulmore dhe sanksionohen në mënyrë urgjente.

Biljana Bogdanovska

Kjo storje hap një problem të nxehtë me të cilin ballafaqohen numër i madh i punëtorëve maqedonas, veçanërisht ato të esnafit gazetar - medial, e kjo është e ash.q. puna e parregullt gj.gj. "punësimet e përkohshme", ose ashtu siç është definuar në Ligjin për marrëdhëniet e punës (2005), ky formulim do të kishte të bëjë me ato persona të punësuar të cilët kanë lidhur kontrata për punësim në kohë të caktuar.

Karakteristika thelbësore e këtij lloji të marrëveshjes juridiko-e punës është ajo që kjo marrëveshje, sipas të gjitha parametrave teorike dhe ligjore, bën pjesë në grupin e "kontratave atipike të punës", respektivisht në një sistem juridik normal, zbatimi i tij do të duhej të jetë përjashtim, e jo rregull! Por, te ne ky është një nga institutet e të drejtës së punës që keqpërdoret më së shpeshti, për arsye se kjo u konvenon punëdhënësve në mënyrë të shkëlqyeshme - për shkak se vetëm në këtë rast, ato nuk janë të obliguar të japin arsytim me shkrim për mosvazhdimin eventual të ardhshëm të kontratës, gjegjësisht vlefshmëria e tij pushon me fuqi të ligjit, thjesht me skadimin e afatit për të cilin edhe është lidhur dhe prej ditës së ardhme personi i cili deri dje ka qenë i punësuar,

tani më bëhet i papunësuar. Te kjo kontratë për punë është simptomatike ajo që siç kalojnë vitet, përdorimi i saj në vend që ligjërisht të zvogëlohet - përkundrazi, ajo zgjerohet!? Respektivisht, në fillim të tranzicionit, në vitet e 1990-ta, parashikohej se kontratat e kështilla jokonvenciale mund të lidhet vetëm në katër situata të theksuara në mënyrë eksplicite, të cilat kushtimisht - sipas parimit të listës së mbyllur (numerus clausus) - mund ti karakterizojmë si "të jashtëzakonshme"

ndërsa sot ajo mund të lidhet edhe për kryerjen e të gjitha "punëve të rregullta", gjegjësisht për rastet e njëjta për të cilat do të rekomandohej dhe do të ishte më e kuptimtë të lidhet kontratë për punësim në kohë të pacaktuar. Kështu, në periudhën deri më 2003, periudha kohore maksimale e lejuar në të cilën mund të punohej me këtë lloj të kontratës ishte një vit, pas së cilës kjo kontratë automatikisht transformohej në kontratë më të volitshme për punësim në kohë të pacaktuar ("punësim i përhershëm"). Mandej, ky afat u ngrit në tre vite! Por, tendenca e ndryshimeve ligjore të pavolitshme nuk u ndal me këtë, kështu që - prej vitit 2005 - afati është prolonguar në katër, që prej vitit 2008 e këndej - ta rrijë zgjatjen e vet maksimale historike, në periudhë prej deri pesë vitesh!

Për këtë shkak, në të ardhmen, sindikatat dhe lidhjet e tyre do të duhet patjetër të bëjnë një presion publik më të madh mbi autoritetet, me qëllim që të arrijnë të kthehet afati i parë prej një viti, i cili ishte në fuqi viteve të para pas pavarësimit të R.Maqedonisë - me qëllim që të evitohen keqpërdorimet tepër të shpeshta të këtij instituti juridiko-i punës i qëllimtë.

KOMENT JURIDIK

1 Ato ishin si vijon: (1) punëtorë sezonal - më së shumti nëntë muaj në një vit kalendarik; (2) vëllim i zmadhuar i punës - më së shumti gjashtë muaj gjatë një viti; (3) zëvendësimi i punëtorit mungues - derisa zgjat mungesa; dhe (4) punë në projekt të caktuar - deri në përfundimin e tij (neni 23, LMP/1993).



Të diskriminuar në çdo aspekt

Pa pajisjen e duhur për kryerjen e papenguar të obligimeve të punës, pothuajse dyfish më pak të paguar, krahasuar me gazetarët nëpër redaksitë, shtatë ditë të javës në punë dhe pa stazh pune të rregulluar. Kështu munden shkurtimisht të grumbullohen kushtet e punës të korrespondentëve nga Tetova, por edhe nga qytetet tjera të vendit.

Reporterët nëpër televizionet nuk kanë kamera zyrtare, ashtu që korrespondentët e televizioneve nacionale të ndryshme e ndajnë një kamerë të njëjtë. Gazetarëve në mediumet e shkruara nuk u japin fotoaparate, edhe pse me çdo tekst kërkojnë të sigurojnë edhe fotografi. Më para janë angazhuar fotografë të cilët kanë qënë në terren së bashku me korrespondentët por, tani nuk është ashtu. Për shembull, prej rreth 60 gazetarëve dhe punëtorëve të medimeve, sa që ka në Tetovë, vetëm disa prej tyre marrin pagë të njëjtë ose po më të lartë se paga mesatare në nivel

shtetëror. Të gjithë të tjerët kanë paga shumë më të ulëta, vetëm disa prej tyre marrin pagë të njëjtë ose po më të lartë se paga mesatare në nivel shtetëror. Të gjithë të tjerët kanë paga shumë më të ulëta. Me qëllim që të arrijnë deri në fund të muajit të fitojnë të hyra prej rreth 20.000 denarë, duhet të punojnë për dy ose tre medime njëkohësisht, por vetëm disa prej tyre arrijnë ta bëjnë këtë.

Nga 150 denarë për një tekst

Njëri nga bashkëbiseduesit tonë është gazetar me përvojë shumë të madhe, pothuajse 50-vjeçare. Në karrierën e deritanishme ka punuar për radio-stacion lokal dhe për ca medime të shkruara. Akoma është

KORRESPONDENTËT
E BRENDISË JANË
"GAZETARË TË
DORËS SË DYTË"
NË MEDIUMET
MAQEDONASE

aktiv si korrespondent. Ka arkivin e vet ku mban evidencë precize dhe pedante të aktgjykimeve gjyqësore për të cilat ka shkruar, të mbledhjeve të vetadministrimit lokal, defter me listë të kontakteve, të radhitura sipas vendit të banimit.

Ka listë tarifore për punë, ndërsa paguhen me honorar ve tekstet e botuara, ashtu që, në varësi nga redaksia, lajmet e shkurta paguhen pre 150-250 denarë kurse temat prej 600 deri në 1.000 denarë. Por, pjesa më e madhe e publikimeve tariforet si lajm i shkurtër.

Ritmi i punës i imponuar në këtë mënyrë, para së gjithash reflektohet mbi cilësinë. Problemi më i madh, siç thotë ai, paraqitet kur e dërgojnë të përcjellë ndonjë ngjarje e mandej nuk do e botojnë tekstin. Ai konstaton se edhe më para, në sistemin e kaluar por edhe sot, korrespondentët punojnë në kushte njëlloj të këqija. Kushtet janë larg dinjitetit dhe janë pakrahasueshëm të këqija, më të këqija se kushtet e gazetarëve në redaksitë.

- Ne, korrespondentët, jemi si zorra qorre e redaksive. Rrallë kur na ftojnë në ahengjet e vitit të ri ose po të tjera. Në këto 12 vite si jam duke punuar për këtë gazetë, vetëm një herë më kanë ftuar në ndonjë aheng. Na trajtojnë si gazetarë të klasës së dytë, nuk kemi trajtim të njëjtë ndërsa produksioni është i njëjti, nëse jo më edhe më i madh – thekson ai.

- Edhe pse nuk kam as së afërmi kushte të njëjta si edhe kolegët e mi në Shkup, botoj edhe nga 60 kontribute. Për dallim prej tyre të cilët mbulojnë sektorë të caktuar, ne korrespondentët, informojmë për ngjarje ditore, prej ngjarjeve sportive deri në mbledhjet e pushtetit lokal, ndërsa njëkohësisht punojmë edhe në reportazhe ose po shqyrtime sportive. Shkruaj në makinë për shkrim, kurse prej redaksisë nuk më kanë pyetur as nëse më duhet letër, diktafon ose po material tjetër amortizues. Mos flas për harxhimet e përditshme siç janë lënda djegëse ose po amortizimi i automjetit, thotë ai dhe shton se jo rrallë ndodh që harxhimet të jenë më të larta se kompensimi për tekstin e botuar.

Një gazetar tjetër me përvojë pune prej 24 vitesh, prej të cilave vetëm nëntë vite janë stazh i pranuar i punës, thekson se nga përvoja e tij e deritanishme, problemi më i madh është puna me honorar, pa aktvendim për punë dhe pa stazh të rregulluar të punës. Edhe ai e përdor automjetin e vet gjatë kryerjes së përditshme të punës. Ka punuar për medime të shkruara dhe për televizion. Në të dy rastet, redaksitë nuk i kanë dhënë as kamerë as fotoaparate.

Tre detyra pune për një honorar

Incizuesi me pak më shumë se 18 vite stazh pune në televizionet lokale dhe nacionale, nënvizon më shumë probleme me të cilat është ballafaquar në karrierën e deritanishme. Përveç asaj që incizon, prej tij kërkohet ta bëjë edhe montazhin, edhe të bëhet vozitës, kështu që,

thekso ai, me një pagë, redaksia fiton tre punëtorë. Problemet i ndan në ato të natyrës teknike dhe financiare. Qe dy vite me radhë si është duke e shfrytëzuar kamerën e vet, për arsye se atë që ia kanë dhënë nga televizioni, është prishur.

- Dhe, qe, riparimi ose furnizimi i kamerës së re zgjat më shumë se dy vite. Redaktorja thotë: gjenduni, kurse drejtori teknik pra, këshillon që edhe unë si edhe taksistët, ta blej kamerën time dhe të punoj me të. Harxhimet, amortizimi, kamera, kompjuteri, interneti, kasetat e incizimit, gjithë këto duhet ti blej prej pagës sime, e cila është shumë më e ulët se paga mesatare në nivel shtetëror, thotë ai.

Sipas tij, kolegët nga Shkupi, përveç asaj që nuk kanë probleme të këtilla, kanë edhe paga dyfish më të larta për punën e njëjtë dhe me cilësinë e njëjtë. Pas tensioneve të gjata, huazimeve të kamerës prej kolegëve, ka qenë i detyruar të huazojë para dhe të blejë kamerë personale.

- Prej nesh kërkojnë të jemi të përgatitur për punë cilëndo ditë në cilëndo kohë, a nuk na japin as mjete themelore për punë. Çdo gjë që përdor momentalisht është e imja, nuk kam asgjë prej televizionit. Kamera ime, stativi, kabllot, kompjuteri për montim, interneti, automjeti dhe një sërë sendesh tjera, konstaton ai.

Gjithashtu, problem i madh është edhe ajo që televizionet nuk paguajnë për amortizimin e automjeteve, ndërsa vonohen me nga disa muaj me kthimin e parave për paratë e harxhuara për lëndë djegëse. U paguajnë nga 600 denarë për çdo njëqind kilometra të kaluar, kurse riparimi eventual i automobilit është në llogari të vetë.

Sipas tij, më së vështiri e kanë korrespondentët të cilët punojnë vetëm për mediumet nacionale. Thekson se kur ka punuar në redaksi në televizion lokal, nuk ka pasur nevojë të shkojë në incizim me automjetin e vet, as të paguajë lëndë djegëse ose po të ketë nevojë të blejë kamerë. Por, kur ka filluar të punojë në mënyrë të pavarur, të gjitha këto probleme kanë dalë në sipërfaqe. Përveç asaj që është dashur personalisht ti sigurojë të gjitha mjetet teknike për punë, ka qenë i detyruar të kryejë detyra pune për tre punëtorë - incizues, montues dhe vozitës.

- Më kujtohet një incident i cili në mënyrë më të ilustruar mund ta përshkruajë paturpësinë e redaktorëve dhe pamundësinë tonë. Duhej të shkohet për incizim në Mavrovë, kurse nga televizioni nuk më paguan harxhime për lëndën djegëse dhe për taksa rruge më shumë se katër muaj. Redaktorja, fillimisht ju paraqit koleges me të cilën punoj, man-

PA ÇFARËDO
MJETETEKNIKE
TË SIGURUARA
PA ORAR TË
KUFIZUAR
TË PUNËS,
PA DITË TË
LIRA DHE MË
PUNË TË PAGUAR
MË SË PAKU...

dej edhe mua. Menjëherë i thashë se nuk mund të shkoj në incizim jashtë Tetovës për arsye se nuk kam para për lëndë djegëse. Ajo, as pa më dëgjuar deri në fund, vetëm më tha: doemos të shkosh në terren dhe e mbylli telefonin. Pas gjysmë ore mu paraqit përsëri për të kontrolluar nëse kemi dalë në terren dhe përsëri i thashë se nuk kam para për lëndë djegëse. Tani më dëgjoji deri në fund dhe kur përfundova, më akuzoi se nuk dua të punoj dhe e mbylli telefonin. Pas një kohe u paraqit përsëri edhe për të tretën herë për të më thënë se gjysma e harxhimeve të mbetura janë paguar. Ju përgjigja se menjëherë shkoj në bankë ti marr paratë dhe pas kësaj në pompën e benzinës për të mbushur lëndë djegëse. Para se ta mbyllë telefonin, vetëm më tha se është e sigurt se nuk kanë qenë paratë problem. Më tha, nuk të punohet - thotë bashkëbiseduesi i jonë.

Sipas tij, e gjithë kjo reflektohet keq edhe në motivimin për punë. Ai thekson se nëse ka mësuar diçka deri tani, kjo është se sa më shumë angazhohet, më shumë e maltretojnë. Gjithashtu, thotë se problem i madh është edhe ajo që nuk kanë ditë të lirë. Edhe përsëri asaj që nuk ka çdo ditë ngjarje, duhet vazhdimisht të jenë në gjendje të gatishmërisë, të gatshëm të dalin në terren, dhe për këtë shkak nuk mund të planifikojnë asgjë, për arsye se nuk dinë se kur mund të ketë e kur nuk do të ketë ngjarje ditore për incizim.

- Jemi vazhdimisht në punë, a nëse duhet të marrish ditë të lirë, atëherë duhet doemos të merresh vesh me ndonjërin nga incizuesit nga televizionet tjera që të të zëvendësojnë atë ditë. Në këtë mënyrë, raportet me kolegët reduktohen në këmbim shërbimesh, thotë ai.

Mn. Kuantitet në vend të kualitetit

Një gazetar më i ri, me stazh 12 vjeçar pune, i cili përveç në televizionin lokal dhe një televizion nacional, punon edhe për një gazetë, një radio dhe faqe-interneti, thekson se televizioni nacional për të cilin punon, nuk i ofron asgjë prej kushteve teknike por, prandaj edhe nuk kërkojnë shumë.

- Thonë, puno aq sa të lejojnë kushtet në televizionin lokal. Sjellja e atillë ndikon edhe mbi honorarin për shkak se televizioni lokal merr një pjesë të honorarit si kompensim për mjetet teknike që i shfrytëzojmë. Më duhet të punoj për tre medime që të arrij të fitoj një pagë mesatare solide, thotë ai.

Gjithashtu, edhe sipas tij, një nga problemet kryesore është ajo që nuk ka ditë të lirë. Thekson se duhet të jetë i gatshëm të dalë në terren cilëndo ditë të javës.

- Në varësi nga mediumi, trajtimi ndaj korrespondentëve mundet edhe të dallojë, të jetë më i mirë ose më i keq. Por, kryesisht ne na shohin si bashkëpunëtorë të jashtëm e jo si pjesë e ekipit. Dhe kështu, duke vrapuar pas kuantitetit, jo rrallë pëson kualiteti i produktit final, përfundon në fund të bisedës.

Një gazetar i mëparshëm me përvojë pune shtatëvjeçare, nënvizon

se kushtet e këqija për punë, paga e ulët dhe mos pasja e perspektivës janë arsyt kryesore për shkak të të cilave nuk punon më si gazetar.

- Kushtet ishin të këqija. Diktafonin e bleva vetë, a na dhanë vetëm një kasetë për tërë periudhën derisa isha atje - thotë ai.

Tani punon në një sektor krejtësisht të ndryshëm, ku, siç thekson ai, gjatë kryerjes së detyrave të punës nuk ka probleme të natyrës teknike.

Një koleg më i ri me përvojë pune tetëvjeçare në gazetarinë televizive dhe të internetit, thekson se nuk ballafaqohet me probleme, për arsye se punon edhe për televizionin lokal prej ku merr kamerë, automjet dhe mjete teknike të tjera të duhura për punë. Problemi më i madh është ai që nuk është i siguar, punon si me honorar me kontratë në vepër dhe po ashtu i ka problem ditët e lira.

- Ne jemi "tezgaxhinj" dhe çdo gjë varet nga ajo se si dhe sa do të arrish të merresh vesh dhe të bësh pazar. Nuk kemi asnjë të drejtë të garantuar, thotë ai në mënyrë prerë.

Një gazetar me përvojë shtatëvjeçare në televizion dhe në radio, thotë se nga këndvështrimi teknik, më së vështiri është të punohet për televizion. Derisa ka punuar për radio i kanë dhënë incizues dhe e ka pasur shumë më lehtë, por tani punon në televizionin lokal kum përveç saj ka edhe një korrespondent tjetër për TV stacionin nacional, a kanë vetëm një kamerë.

- Jemi gjithsej pesë gazetarë dhe dy incizues, a kemi vetëm një kamerë. Kur duhet të merremi vesh për incizim, prioritet ka televizionin lokal, mandej ne. Për shkak se nuk e kam kamerën time, nuk mund të caktoj incizim atëherë kur mundem ose po kur dua vetë, as që mundem të planifikoj kontribute që për përpilim kërkojnë më shumë kohë. E gjithë kjo situatë reflektohet keq mbi mua dhe mbi punën time. Nuk e di ku, as e di nëse mund të ankojem, të kërkoj ndihmë, a sinqerisht, as që shoh rrugëdalje nga gjendja momentale, thotë ajo.

Kontrata e saj është si vijon. Punon falas për televizionin lokal i cili si përgjigje i ja jep kamerën për shfrytëzim, ndërsa paguhet vetëm nga stacioni nacional i cili jep honorar vetëm për të edhe atë nga 600 denarë për kontribut të emetuar. Nuk paguajnë incizues, as montues, nuk japin para as për transport dhe për harxhime të tjera. Kolegu i saj, me të cilin e ndajnë kamerën e vetme të televizionit lokal, ka shtatë vite përvojë pune edhe atë për TV, radio, internet dhe gazetë.

- Nuk kam pranuar asgjë nga televizionin nacional për të cilin punoj. Nuk më kanë dhënë asgjë. As telefon, as kamerë, as stativ, as mikrofon, as automobil, as lloptop as kompjuter për montim. Rrallëherë pranojnë harxhime dhe çdo gjë paguan nga paga jote. Për shkak të kësaj, nuk

NE JEMI
"TEZGAXHINJ" DHE
ÇDO GJË VARET
NGA AJO SE SA
DHE SI DO TË
ARRISH
TË MERRESH VESH
DHE TË BËSH PAZAR

mund ta japësh maksimumin prej vete dhe në vend që mendosh për kontributin, për atë se si ta përpilosh në mënyrë kreative, të hulumtosh për të pasur informata para se të dalësh në terren, unë duhet të organizoj gjithçka. Ta kontraktoj kamerën, mandej të siguroj transportim, të merrem vesh me bashkëbisedues. Më para, prej televizionit për të cilin punojë paraprakisht, ndërsa tani është mbyllur, na dhanë kamera të vogla dore, por sot resurset teknike duhet ti siguroj vetë. Kreativiteti humbet gjatë organizimit, thotë ai në mënyrë të prerë. Edhe përskaj asaj që nuk i kanë siguruar as minimum mjete për punë, fajin për Edhe përskaj asaj që nuk i kanë siguruar as minimum mjete për punë, fajin për punën e pambaruar në kohë, redaktorët ia hedhin vetëm korrespondentit dhe nuk pranojnë asnjë arsytim të natyrës teknike.

Incizuesi i tij dhe montuesi, i cili është me përvojë dyvjeçare dhe njëlloj si edhe ai punon për televizionin lokal dhe nacional, thotë se për shkak se nuk kanë kamerë, nuk mund të arrijnë në kohë me përm-bushjen e detyrave të punës. Incizojnë edhe për televizionin lokal prej të cilit i përdorin mjetet teknike edhe për atë nationale prej ku marrin honorar.

- Nuk mund të arrijmë t'i përmbushim të gjitha detyrat, dhe kjo na frustron, edhe pse ne përipiqemi të jemi maksimalisht profesional, thotë ai.

Një redaktore në stacionin lokal, me përvojë gazetare 27-vjeçare në të gjitha platformat e mediumit, thotë se më para televizioni ka qenë shumë më mirë i pajisur, por ashtu siç kalon koha, pajisja amortizohet, ndërsa mjete për të re nuk ka.

- Gjendja e atillë krijon probleme dhe reflektohet në mbulimin e ngjarjeve. Një pjesë të temave nuk mund ta mbulojmë, kurse seleksionimi se ku të shkohet e ku jo, është i rreptë. Jo rrallë jemi të detyruar të këmbëjmë incizime me televizione të tjera ose ekipe korrespondentësh, me qëllim që të arrijmë të mbulojmë a më shumë ngjarje, thekson ajo.

Insistimi në anonimi

Është simptomatike edhe ajo që të gjithë gazetarët që pranuan të flasin në këtë temë, insistonin të mbesin anonim. Vështirë vendosnin të flasin për arsye se, siç thonë, nuk besojnë se çfarëdo do të ndryshohej në të ardhmen e afërme.

Kushtet e këtilla supstandarde për punë në të cilat janë të ekspozuar korrespondentët nga brendia e Maqedonisë, ballafaqohen me të drejtën elementare të njeriut për punë dinjitoze. Kjo e drejtë e rëndësishme ekonomiko – sociale është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare – juridike, me konventa dhe deklarata të pranuar në shoqëritë e civilizuar. Respektivisht, me këtë rast, do të theksojmë se në këtë raste, cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë disa nene kryesore të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut (1948), të miratuar nga ana e Kombeve të Bashkuara¹, ku Republika e Maqedonisë është vend-anëtar i plotfuqishëm prej vitit 1993. Për shembull, në DUDNJ, ndër të tjerat, shkruan se “secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë në sigurim social dhe të drejtë të realizojë të drejta ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të domosdoshme për dinjitetin e tyre dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit të tyre” (neni 22); a, gjithashtu, garantohet se “secili ka të drejtë pune, të zgjedhjes së lirë gjatë punësimit, në kushte të drejta dhe kushte të kënaqshme për punë dhe në mbrojtje nga papunësia. Secili, pa asnjë diskriminim, ka të drejtë në pagë të barabartë për punë të njëjtë. Secili që punon, ka të drejtë në kompensim të drejtë dhe të kënaqshëm i cili atij dhe familjes së tij, i siguron ekzistencë e cila i përshtatet dinjitetit njerëzor dhe i cili, në rast se ka nevojë, do të plotësohet me mjete tjera nga mbrojtja sociale” (neni 23). Më tutje,

proklamohet në mënyrë të prerë se “secili ka të drejtë në pushim dhe argëtim, duke e përfshirë edhe kufizimin e kuptimit të orarit të punës dhe pushimet e kohëpaskohshme të paguara” (neni 24); dhe, përfundimisht se “secili ka të drejtë në standard jetësor që i siguron shëndet dhe mirëqenie atij dhe familjes së tij...” (neni 25). Me rëndësi është edhe ajo që asnjë dispozitë nga kjo Deklaratë nuk mund të interpretohet si e drejtë për cilindo shtet, grup ose person të


bëjë çfarëdo veprimi ose pune të drejtuar kah rrënimi i të drejtave dhe lirive që përmbahen në të (neni 30).²

Në të ardhmen, do të duhet të gjetet mënyrë që si këto korrespondentë të inkuadrohen në “tregun legal të punës”. Kjo, në përputhje me rregullativën ekzistuese juridike - të punës, do të mund të realizohet në mënyrën më pak të dhimbshme në atë mënyrë që shtëpitë e medimeve të cilat kanë koncesion nacional do të jenë të obliguara, si kusht për fitimin e koncesionit – me rrjetin e tyre korrespondent nga brendia – të kenë lidhur ca nga llojet ekzistuese të kontratave për punë, të parashikuara në LMP aktual (për shembull: kontrata për punë me orar jo të plotë të punës – e ash.q. part time job; kontratë për punësim me orar të shkurtuar të punës te më shumë punëdhënës – e ash.q. marrëdhënie e dyfishtë e punës; kontratë për bërjen e punës në shtëpi dhe ngjashëm).

¹ DUDNJ është miratuar në vitet e para të themelimit të OKB, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, a e proklamuar me Rezolutën e KB 217 A (III) nga ana e Asamblesë Gjenerale, më 10 dhjetor 1948. Qasje në tekstin mund të keni në këtë link: http://www.dadalos.org/mzd/Menschenrechte/grundkurs_mr2/Materialien/dokument1.htm.

² Dispozita të ngjashme përmbajnë edhe: Pakti ndërkombëtar për të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore (1966) të OKB; mandej Karta sociale evropiane (1961) e Këshillit të Evropës dhe Shtesat e saj të ash.q. anekse, si edhe Protokollet plotësuese (1988 + 1991 + 1995 + 1998); si edhe Marrëveshja evropiane për të drejtat fundamentale e BE.

KOMENT JURIDIK



■ Një armatë gazetarësh janë të detyruar të punojnë “në të zezë”

Punësimi me honorar, me kontratë në vepër, me kontratë për kompensim autori, kontratë praktikanti... – këto janë vetëm një pjesë e mënyrave me të cilat punëdhënësit e medimeve e emërojnë mbulesën formale për praktikën e përhapur të privimit të punëtorëve të mediumit nga të drejtat themelore nga Ligji për të drejtat e punës.

Në mënyrë formale-juridike, ato njerëz janë të papunësuar, por realisht, ato janë të obliguar që të kalojnë çdo ditë, orar të plotë të punës në hapësirat e punëdhënësit, shpesh herë nuk guxojnë të bashkëpunojnë me medime tjera, a u është marrë edhe siguria themelore që rrjedh nga kontrata e punës që do u takonte duke e marrë parasysht mënyrën në të cilën janë angazhuar te punëdhënësi.

Prej tyre pritet të punojnë nga tetë orë në ditë, njëlloj sikur të ishin të punësuar në mënyrë të rregullt. Këto gazetarë nuk kanë as sigurim shëndetësor, as pensional dhe me qëllim që ti mbajnë “pagat” e veta në formë të honorarit, doemos të punojnë

edhe gjatë vikendeve, a ndonjëherë edhe gjatë festave ose po, ditët e pushimit mjekësor për shumicën prej tyre janë nocion i imagjinuar.

Te punëtorët e medimeve, ky trend i anashkalimit të Ligjit për marrëdhëniet e punës dhe i manipulimit me mundësitë për punën praktikante ose me honorar, si edhe me Ligjin për të drejtat autnore, me anë të së cilit jepet mundësi për bashkëpunim nëpërmjet veprës autoriale, krijojnë një armatë të gazetarëve të cilët janë të detyruar të punojnë de fakto “në të zezë”. Shumica e tyre, edhe përsëri angazhimit me dekada me honorar – nuk kanë asnjë ditë stazh pune.

PREJ ATYRE ME
HONORAR PRITET TË
PUNOJNË NGA TETË
ORË NË DITË, NUK
KANË SIGURIM
SHËNDETËSOR DHE
PENSIONAL, DOEMOS
TË PUNOJNË BILE EDHE
GJATË VIKENDEVE ...

Të lumtur që pranojnë honorar

Tepër të lumtur që kanë hyrje mujore, shumica gazetarëve me kontrata të këtilla heshtin dhe, edhe pse janë “me honorar” ose po kanë nënshkruar kontratë për vepër autoriale, punojnë silur të jenë të punësuar në mënyrë të rregullt.

Një gazetar në një gazetë ditore, i cili për shkaqe të kuptueshme dëshironte të mbesë anonim, thotë se edhe pse punon pothuajse pesë vite në medium, për herë të fundit ka parë kontratë para dy viteve.

- Deri atëherë nënshkruaja kontrata mujore për kompensim autori, që zakonisht na i jepte sekretaresha të gjithëve për nënshkrim në fund të vitit. Me siguri akoma vlen kontrata e njëjtë vetëm se nuk kam informatë kush e nënshkruan, për shkak se nuk jam unë ajo. Paratë gjithashtu, i transferojnë si kompensim autori. Në kontratë qëndronte se pala e obliguar pranon kompensim në lidhje me numër të caktuar të teksteve të dorëzuara për të cilat ia jep të drejtat autoriale redaksisë. Mirëpo, për shkak se nuk ka sistematizim, honorari është gjithnjë i njëjtë, me vite – thotë gazetar.

Sipas tij, edhe pse nuk është i punësuar rregullisht, punëdhënësi prej tij pret ti përmbushë obligimet e punës njëllor sikurse të ishte i punësuar. Ka njësoj obligime, si edhe kolegët me marrëdhënie të rregulluar të punës, ndërsa është e obligueshme të punohet koha e njëjtë, si edhe kolegët tjerë të punësuar, edhe pse në kontratë nuk është parashikuar asnjë lloj i orarit të punës. Rrëfen se para do kohe, është vonuar 20 minuta në punë dhe e kanë paralajmëruar publikisht, para të gjithë kolegëve, me fjalët “a e di se prej sa ora je në punë?”

Ai, gjatë arritjes së mëngjesit, njësoj si edhe atë të punësuarit rregullisht në gazetë, është i obliguar të nënshkruhet në listë deri në ora 9.30. Shembulli më i freskët i të (pa) drejtave të atyre me honorar, që ka ndodhur në këtë medium para një muaj, është kur të gjithë të punësuarit është dashur detyrimisht të vizitojnë kurs njëorësh për siguri gjatë punës, por jo edhe ato me honorar, sikur siguria e tyre nuk është aspak e rëndësishme.

- Sigurimi shëndetësor dhe pensional janë nocion i imagjinuar për ato me honorar. “Privilegji” i vetëm është pushimi vjetor i paguar prej vetëm dhjetë ditë ndërsa për pushim mjekësor nuk di për arsye se asnjëherë nuk e ka kërkuar këtë. Për dy ditë, aq sa kam munguar, nuk kanë bërë problem dhe kjo nuk është reflektuar në honorarin tim për shkak se as që ka si të rregullohet kjo ligjërisht – shton gazetari.

Gazetarja në një medium onlajn, e cila gjithashtu dëshironte të mbesë anonime, thotë se kontrata për vepër autoriale është e zakonshme për gazetarët me honorar, veçanërisht për ato që punojnë në ueb portalet, ashtu që edhe ajo tani më disa vite e fiton bukën në këtë mënyrë.

- Kontratë në këtë vend pune nënshkruaj në një ose ndonjëherë në dy muaj, por shpeshherë me përmbajtje të ndryshme në raport me obligimet, por me lartësinë e kontraktuar të honorarit. Në vendin paraprak të punës, për shembull, ku mbeta më shumë se një vit, aspak nuk kisha nënshkruar kontratë por vetëm më paguhej honorar, ndonjëherë në llogari, ndonjëherë në dorë. Për paraqitje as që bëhej fjalë, arsyetimi zakonisht është se nuk ka para, se është krizë dhe se ka gazetarë sa të duash. Së këndejmi, zgjedhja e momenteve do të ishte: ose puno falas, ose rri në shtëpi pa punë – thotë gazetarja nga portali.

Njësoj si edhe kolegu i saj nga gazeta ditore, edhe prej saj pritet ti përmbushë obligimet e punës dhe sikurse të jetë në marrëdhënie të rregullt të punës, bile edhe shumë më mirë prej atyre gazetarëve që janë të paraqitur.

- Mua ligji nuk më mbron, kontratat i nënshkruaj muaj për muaj, kush pra më garanton se muajin e ardhshëm do të mbes në punë, nëse nuk është bërë çdo gjë siç duhet. Në lidhje me pasojat, edhe në vetë kontratën shkruan se nëse puna nuk është bërë siç duhet, punëdhënësi ka të drejtë mos e paguajë honorarin e tërë. Punohet edhe gjatë vikendeve, punohet edhe gjatë festave. Nëse doni vikend të lirë, duhet të zëvendësoheni me kolegun, por kjo nuk do të thotë se do të duhet patjetër ta ktheni vikendin e ardhshëm. Më ka

ndodhur, të punoj pa asnjë ditë të lirë edhe një muaj të tërë – shton gazetarja.

Është pesimiste se do ia rregullojnë statusin e punës, për arsye se në mediumin ku punon, pjesa më e madhe e gazetarëve janë të paraqitur, pranojnë honorar dhe në ndërkohë kërkojnë punë të re.

- Punëdhënësit thonë se nuk ka para, se vështirë arkëtohen reklamat, se donatorët japin thërrime. Kur edhe vetë honorarët janë të mjerë, pjesës së madhe të kolegëve të mi as që u shkon ndërmend të kërkojnë ti paraqesin. Por, për këtë shkak, edhe mediumet pësojnë. Punëtorë të pakënaqur, nuk shkruajnë tekste të shkëlqyera. Shumica thonë: sa para, aq muzikë. Prandaj edhe mediumet në Maqedoni janë të atilla siç janë – thotë gazetarja e këtij mediumi onlajn.

Një tjetër kolege e saj, e cila punon në një medium tjetër onlajn, gjithashtu thotë se asnjëri nga gazetarët e angazhuar në medium nuk kanë punësim të rregullt.

- Nuk ka premtim nga punëdhënësi për rregullimin e marrëd-

GAZETARI I CILI
TREMBET SE DO TË
MBESË LEHTË DHE
SHPEJT PA HONORARIN
E VET, AS QË I
SHKON NDËRMEND TU
KUNDËRVIHET
EPRORËVE TË VET
PREJ TË CILËVE I
VARET EKZISTENCA

hënies së punës, a përgjigja më e shpeshtë që e marr është se nuk kanë mjete përpunim të përhershëm. Sa që di unë, të gjithë kolegët që punojnë në mediumin tim janë me kontrata autori, respektivisht asnjëri prej tyre nuk është i punësuar rregullisht. Nuk kam as sigurim shëndetësor, as pensional – thotë gazetarja onlajn.

Në përpjekje ta rregullojë statusin e vet me honorar, një koleg u pajtua praktikisht të punojë pa para, ndërsa kompensim financiar të kërkojë në angazhimet plotësuese të punës.

- Para një viti, kur mbusha 40 vite të jetës dhe kur kuptova se asnjë nga institucionet kompetente nuk kujdeset për të punësuarit në firmat private, vendosa që ta ndërmarra punën në duart e mia. Kështu, u mora vesh me pronarin që me honorarin që e pranoja si kompensim për punën time, të ma paguajë sigurimin. Prej parave që i pranoj në llogarinë time nuk mbaj asnjë denar, por tërë shumën ia kthej pronarit – na tha kolegu.

- Falë kësaj, tani mund të lavdërohem se tani kam një vit stazh të verifikuar të punës, por për fat të keq, nuk marr asnjë denar për punën time në atë medium. Gjendja në të cilën jam në nivelin profesional, më irriton gjithnjë e më shumë prej dite në ditë, për këtë shkak edhe jam duke menduar a mundet edhe do e bëj këtë, ta braktis gazetarinë, dhe, si të më japë Zoti” – thotë ai.

Lehtësia e padurueshme e pushimit nga puna

Arsyetimi kryesor i pronarëve për angazhimet me honorar dhe angazhimet tjera joformale të gazetarëve dhe të punëtorëve të medimeve është mungesa e mjeteve financiare, gjegjësisht mundësi të evitohet pagesa e shumë më të lartë të kontributeve në situatë kur përfitimi në biznesin e medimeve është minimale.

- Gjithsesi se financat janë problem. Veçanërisht për portalet që akoma nuk janë aq atraktiv për reklamim për dallim nga vendet e zhvilluara. A, përveç reklamave, nuk kemi hyrje të tjera, parapagesa në portal akoma nuk funksionon te ne. Lexuesit duan informatë falas, Njëfarë përfitimi kanë vetëm portalet proqeveritare që kanë reklama qeveritare. Por, edhe atje nuk e di nëse të gjithë të punësuarit janë të siguarur dhe çfarë paga marrin – thotë një pronar i një portali njohur onlajn.

Dhe, me të vërtetë, prania e atyre me honorar, e praktikantëve, respektivisht gazetarëve të angazhuar me kontratë autori në vend që me kontratë për punësim, nuk është e rezervuar vetëm për medimet që mezi mbijetojnë në treg. Ato ekzistojnë edhe në medimet më të forta, bile edhe në servis publik edhe pse prej atje vazhdimisht e demantojnë këtë.

Redaktorët në medimet, ato me të cilët gazetarët shpeshherë duhet të bisedojnë rreth pagave dhe përparimit në vendi e punës,

janë skeptik se kanë fuqi të ndryshojnë diçka në të mirë.

- Duke e marrë parasysh se me të vërtetë kemi vështirësi financiare, çdo çështje sindikale pronarët e përjetojnë si luks. Pronarët kanë arsytim se në këtë mënyrë i zvogëlojnë harxhimet, nuk paguanë kontribute, për arsye se mediumi realisht gjendet në situatë të palakmueshme financiare”, thotë redaktori i një mediumi të shtypur.

Përsëri, konsideron se financat nuk mund të jenë argument mjaft i mirë për sjelljen e tillë ndaj bashkëpunëtorëve.

- Sipas meje, ka mundësi të punësohen të gjithë, përsëri, ato nuk janë harxhime tepër të mëdha kur do të merren parasysh përfitimet për të punësuarit dhe nëse zvogëloheshin edhe disa harxhime të tjera, nëse bëhej një racionalizim e mirë në firmë – thotë ai.

Dhe, me të vërtetë, përveç përfitimit financiar për pronarët, statusi me honorar i të angazhuarve në mediumin jep mundësi për pushimin e tyre të lehtë dhe të shpejtë pa çfarëdo problemi për menaxhmentin. Shpejtësia dhe mënyra se si zbatohen vendimet e atilla flet për mosekzistimin e as obligimit moral ndaj njerëzve të cilët me vite kanë qenë besnik ndaj redaksive të veta.

Këtë më së miri e ilustron rasti në verën e vitit 2012, kur një nga botuesit më të mëdhenj të gazetës, vendosi të “lirohet” nga një pjesë e rrjetit të korrespondentëve, për arsye financiare. Duke e marrë parasysh se shumica e gazetarëve ishin të

angazhuar si korrespondentë, kishin statusin me honorar, shpeshherë, pa çfarëdo dokumenti të shkruar, vetëm me marrëveshje gojore, shtëpia i lejoi vetes siç pohonin atëherë të pushuarit nga puna, që një pjesë të tyre tua abrogojë angazhimin vetëm me një tekst mesazh me anë të telefonit celular.

Efektet e pasigurisë së këtillë ekonomike dhe sociale, reflektohen drejtpërdrejtë mbi cilësinë por edhe mbi integritetin e produktit gazetar. Gazetari i cili trembet se lehtë she shpejtë do të mbesë pa honorarin e vet, as nuk i shkon ndërmend ti kundërshtojë të supozuarit e vet prej të cilëve i varet ekzistenca.

Në biseda joformale, kurrë në mënyrë publike, ato nuk fshehin se nuk guxojnë të shkruajnë tekst në të cilin do të ketë çfarëdo qëndrimi i cili nuk është në përputhje me politikën redaktuese.

- Apriori di çka është e lejuar a çka nuk është për botim. Nuk jam e paraqitur dhe mund të më pushojnë nga puna në cilëndo kohë, kështu që, nuk rrezikoj shumë në botimet dhe nuk futem në tema për të cilat supozoj se nuk janë të lejuara nga pronarët. Autocenzura

KRD- NË VITIN
2012 NË
TELEVISIONET
LOKALE PREJ
NUMRIT TË
PËRGJITHSHËM TË
GAZETARËVE TË
ANGAZHUAR, 45%
KANË PASUR STATUS
ME HONORAR

përfundimisht funksionon si te mua, ashtu edhe te shumica e kolegëve” – na tha një kolege.

Punësimet joformale janë të paligjshme

Kushtet e këqija ekonomike në të cilat realisht funksionojnë medimet në Maqedoni, veçanërisht ato që nuk kanë qasje te mjetet që nën vellon e “reklamave qeveritare”, derdhen në buxhetin e firmës, oferta e madhe dhe kërkesa e vogël në tregun e medimeve e bëjnë të veten dhe shumë kolegë tanë nuk kanë zgjidhje, përveç që vite me radhë ta pranojnë këtë gjendje deri në çastin derisa mos u ndërpritet bashkëpunimi. Në fund, mbesin edhe pa punë, edhe pa stazh edhe pa çfarëdo mundësi për ankesë.

Ligji për marrëdhëniet e punës në Maqedoni njih lloje të ndryshme të kontratave për angazhim pune, deri në dhjetë lloje, por nuk njih kontratë në vepër dhe praktika e këtillë paraqet cenim dhe anashkalim të të drejtës së punës.

“Gazetarët që punojnë rregullisht, me obligim për të ardhur në punë dhe për ti kryer obligimet e përditshme të punës, punëdhënësi është i obliguar ti paraqesë, respektivisht të lidhë me to kontratë për punësim dhe ti paraqesë në sigurimin e obligueshëm social. Ka raste kur gazetar i caktuar paraqitet vetëm si autor i një emisioni të caktuar, ose shkrimit, artikullit ose ndonjë vepre tjetër autoriale, për të cilat marrëdhëniet ndërmjet shtëpisë së mediumit dhe gazetarit mund të rregullohen me kontratë autoriale. Forma tjera të angazhimit të punëtorëve nuk ekzistojnë, gjegjësisht nuk janë parashikuar me ligj”, theksojnë nga Ministria e Punës dhe Politikës sociale. Kërkuam informatë nga Ministria për atë se cilat masa ndërmerren për ta parandaluar cenimin e këtillë të ligjeve në medimet dhe nëse janë zbatuar inspektime në shtëpi të caktuara të medimeve ku ka sugjerime prej gazetarëve se nuk respektohet Ligji për marrëdhëniet e punës, por nuk marrim përgjigje të hollësishme në këto pyetje.

Prej atje thonë se Inspektorati Shtetëror i Punës bën çdoherë kontrolle pas parashtrësive të të punësuarve, ashtu që, prej këtij rregulli nuk janë të përjashtuara as shtëpitë e medimeve.

Megjithatë, praktika dëshmon se ky lloj i punësimeve joformale është dukuri e shpeshtë dhe publike në biznesin e medimeve. Në fakt, gjithçka që duhet të bëjnë inspektorët e punës është ti hapin të dhënat publike të Këshillit të Radiodifuzionit të Republikës së Maqedonisë, ku në mënyrë precize është theksuar struktura e të punësuarve në industrinë e radiodifuzionit (televizione dhe radio) dhe ku zëri “status me honorar” është plotësuar në mënyrë të rregullt.

Vetëm për ilustrim të dhënat për vitin 2012 të Këshillit për ra-

diodifuzion flasin se te televizionet lokale për shembull, prej numrit të përgjithshëm të gazetarëve të angazhuar, 45% janë me status me honorar.

“Pjesëmarrja e tyre është zmadhuar për shtatë përqind në krahë me vitin e kaluar”, konstaton Këshilli i Radiodifuzionit në analizën prej 2012.

Situata është më e keqe te televizionet rajonale ku përqindja e atyre me honorar është më e madhe se numri i të punësuarve të rregullt.

Është interesant se në rast se inspektorati i punës dëshiron, mund ti përmbahet ligjit dhe ti sanksionojë punësimet joformale, dhe e bën këtë por, vetëm në disa medime.

Pronari i një televizioni lokal ku inspektorati i punës ka hyrë dhe ka kërkuar të gjithë bashkëpunëtorët me honorar të paraqiten, na deklaroi se është i habitur nga fakti që disa kolegë të tij, pronarë të medimeve, pohojnë se te ato angazhojnë me honorar dhe se inspektorët këtë e tolerojnë, bile ka edhe konkurse publike për punësim me honorar, gjë që e konfirmon seleksionimin dhe standardet e dyfishta gjatë zbatimit të ligjit.

- Unë nuk pohoj se ligji është i mirë, por konsideroj se duhet të rrespektohet... dhe më irriton sjellja seleksionuese e shërbimeve inspektore të cilat diku këmbëngulin fortë ta zbatojnë ligjin ndërsa diku kanë sjellje toleromi. Sistemi i arshinit të dyfishtë këtu është krejtësisht i pranishëm – thotë ai.

Nuk ka barrierë juridike për sigurim pensional dhe shëndetësor!

Përveç rregullimit të statusit të këtyre punësimeve “në të zezë”, me punësim të rregullt nga ana e punëdhënësve, si një nga zgjidhjet e mundshme për zbutjen e problemeve të atyre “me honorar” nëpër medimet është edhe ndryshimi i ligjeve me ç’rast punëdhënësit do të jenë të obliguar të paguajnë sigurim pensional dhe shëndetësor dhe për honorar të paguar.

Respektivisht, dukuria e punësimeve joformale nuk është ekskluzive vetëm për Maqedoninë. Ato, nën emrin e përbashkët, “prekarizmat”, ekzistojnë edhe në vendet tjera. Por, për dallim nga Maqedonia, për prekarizmat, në Evropë debatohet ndërsa një pjesë e vendeve filluan ti pranojnë ato të drejta pune të ash.q. të “domosdoshme” edhe të të punësuarve joformal. Për shembull, u jepet e drejtë e afatit për pushim nga puna, e shpenzimeve të përcjelljes, e sigurimit social themelor.

Kështu, ligji francez me të cili rregullohet pozita e medimeve (Loi Cressard), i miratuar në parlamentin francez në vitin 1974, gazetarëve me honorar ua pranon (të ash.q. „journalistes pigistes“), status të gazetarëve profesional, së bashku me të gjitha të drejtat e

punës dhe ato profesionale, si edhe të gjitha të drejtat që përmbahen në marrëveshjen kolektive ndërmjet gazetarëve dhe punëdhënësve. Zgjidhjet në këtë Ligj janë futur edhe në Ligjin francez për punë (Code de travail). Veçanërisht është me rëndësi të thuhet se praktika gjyqësore në Francë u ofron mbrojtje sistematike gazetarëve me honorar, përkundër përpjekjeve të botuesve që t'ua kontestojnë të drejtat e punës me qëndrimin se "sjelljen honorare të gazetarit e përcakton mënyra në të cilën paguhet fitimi, por kjo me asgjë nuk i derogon të drejtat e tyre të punës."

Jo rastësisht në Kartën për të drejtat e gazetarëve të lirë të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve insistohet që frilenserët ti kenë të drejtat e njëjta si gazetarët me punësim të përhershëm: të drejtë pushimi mjekësor, të sigurimit pensional, të mungesës së lindjes, të mbrojtjes sindikale dhe negocimit kolektiv .

Në Serbi për shembull, për punë në bazë të kontratës në vepër, punëdhënësit paguajnë kontribute për sigurimin pensional dhe invalidor. Sipas Ligjit serb për sigurim shëndetësor, personat të cilët botojnë diçka në bazë të kontratës në vepër, në bazë të kontratës autoriale, si edhe për kontratat tjera me të cilat për punën e kryer realizohet kompensim financiar, konsiderohen për persona fizikë të cilët janë detyrimisht të siguruar shëndetësor.

Ekspertët nga fusha e të drejtave të punës thonë se asgjë nuk e pengon shtetin tu ndihmojë atyre "me honorar" ose po të gjithë të tjerëve me status të këtillë të punësimit "alternativ" dhe për këtë nevojitet vetëm vullnet politik.

Profesori Zdravko Saveski konsideron se segmenti i klasës punëtore që bën pjesë në kategorinë prekarijat ose kategori e punëtorëve me vend të pasigurt të punës është në rritje.

- Punëdhënësit, për momentin paguajnë vetëm tatim personal për honorarët e këtillë. Nuk ka barrierë juridike se pse edhe për pagimin e të gjitha mënyrave alternative të punës të mos paguhet kontribute për sigurim social të detyrueshëm. Për këtë nevojitet vetëm vullnet politik dhe ndryshim i ligjeve në atë drejtim – shton Saveski.

Kristina Ozimec

Në rrethana maqedonase, forma më e shpeshtë e lajthitjes së rregullave nga sfera e marrëdhënieve të punës është e ash.q. punë honorari. Gjegjësisht, kjo “punë” në fakt nuk është punë në kuptim të plotë të fjalës, për shkak se këto njerëz, në mënyrë juridiko-formale nuk trajtohen si “punëtorë”, gj.gj. sipas të drejtës tonë pozitive ato trajtohen si persona të papunësuar. Emër tjetër për këtë kategori më të madhe të “punëtorëve” është edhe emërtimi prekarijat ose po, frilenser – që është vetëm nocion i eufeminizuar prapa të cilit fshihet realiteti i përditshëm i vrazhdë në të cilin jeton kjo “klasë e re” e bashkëqytetarëve tanë. Karakteristika thelbësore për to është pasiguria e gjoja se “vendit të tyre të punës”. Respektivisht, e drejta maqedonase e punës nuk e njuh aspak punësimin e ash.q. me honorar! Dhe këtu, nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë dilemë juridike. Në fakt, edhe tendenca e LMP të ri dhe akoma aktual ishte që përmes vendosjes së një sërë të llojeve të reja dhe atipike të kontratave për punë (si për shembull: kontratë për punësim në kohë të caktuar, kontratë për stazh praktikanti ose vullnetari, kontratë për kryerjen e punës në shtëpi, kontratë për punësim me orar të shkurtuar të punës te një ose më shumë punëdhënës, kontratë për punë plotësuese, kontratë për punë provuese, kontratë e veçantë për kryerjen e punëve saktë të përcaktuara dhe ngjashëm) – të vendoset

KOMENT JURIDIK

rregull në punën “në të zezë”, prej të cilave përveç punëtorëve, është i dëmtuar edhe shteti, për arsye se tolerohet dhe stimulohet i ash.q. tregu i zi i punës. Por, te ne, zbatimi i këtyre dispozitave të LMP nuk zbatohet në praktikë, kurse fajin për këtë mund ta loçojmë më së shumti në inspektoratin e punës dhe toleromi i tij i këtyre dukurive, edhe pse ka mekanizma të përhershme juridike për sanksionimin e tyre. Kjo për faktin se kjo “punë”, kryesisht e paguar

pak, në fakt është kategori juridike e të drejtës së obligacionit e jo të asaj të punës! Kështu, në vend të Ligjit për marrëdhëniet e punës (2005), në këto raste zbatohet Ligji për marrëdhëniet e obligacionit (2001) ose Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e afërme (2010). Kjo, në anën tjetër, hap një seri të problemeve tjera me të cilat ballafaqohen këto persona “me honorar”: gjegjësisht, për to aspak nuk paguhen kontribute; ato nuk kanë sigurim shëndetësor ose pensionalo-invalidor; nuk janë të paraqitur si persona të punësuar; nuk u rrjedh stazhi dhe nuk u takojnë asnjëfarë të drejta ose privilegje punëtore, për të cilat në të ardhmen do të mundeshin për shembull, të iniciojnë kontest gjyqësor me qëllim që ti mbrojnë.

Drejtimi për tejkalimin e kësaj situate e cila te ne tani më merr përmasa alarmuese dhe brengosëse, është të përcillen përvojat krahasuese nga vendet tjera dhe të shqyrtohet mundësia për vendosjen ligjore të kontributeve obliguese për sigurim edhe te ky lloj i kontratave, në të cilën mënyrë punëdhënësit do të destimuloheshin për të bërë abuzim të të drejtës.

¹ Shih më shumë <http://www.ifj.org/en/pages/ifj-efj-freelance-charter>



■ Pronarët, redaktorët dhe politikanët i bënë të heshtin, gazetarët pranuan

Ke storje të shkëlqyer. Porsa të ranë në dorë dokumente për tenderë të dyshimtë. Po, publikimi i tyre do të jetë interesant për publikun. Por, kushedi për të satën herë vendos të mos i përmendësh në kolegjiun e mëngjesit, vetëm me qëllim që ti reduktosh situatat nervoze. Herën e kaluar kur tentove të shtysh një storje të ngjashme, humbe një orë në bindje

me redaktorin, i cili të bindte se kjo nuk është e rëndësishme për publikim, edhe pse si gazetar je i bindur se është. Në fakt, është sekret publik se mediumi në të cilin punon është i afërm me pushtetin dhe se thjesht nuk ka shanse të kalojë diçka kundër strukturës qeveritare.

Prandaj, thjesht, pas disa orvatjeve të pasuksesshme të shtysh përpara tema kritike ose hulumtuese, kupton se është shumë më lehtë të punosh në storje që nuk e prekin askënd në mënyrë të veçantë.

Kështu, me kalimin e viteve, tehu i yt gazetaresk çmprihet, humbet dhe fillon të mos i vëresh ato punë të cilat më para syri i yt gazetaresk nuk i lëshonte. A, çdo gjë filloi si autocenzurë.

Storjet e mëdha i lë për dikë tjetër.

Kurse ai tjetri, është gjithnjë më i rrallë në gazetarinë maqedonase. Disa gazetarëve të redaksive të ndryshme të cilët kanë përvojë pune prej më shumë se një decenie, në vend të interesit publik, autocenzura u ka ndërhyrë thellë nën lëkurë.

ËSHTË OBLIGIM I
GAZETARËVE TË
INFORMOJNË PËR TË
VËRTETËN. POR, KJO
MARRËVESHJE E
PASHKRUAR MES
GAZETARËVE DHE
PUBLIKUT MOTI
ËSHTË SHKELUR

Marrëveshje e heshtur me veten

Sipas definicioneve, autocenzura është akt i censurimit të punës personale për shkak të frikës prej pasojave.

Mendojnë rreth temave për përpunim, heshtin për informata, për shkak se e dinë se nuk do të publikohen, për arsye se janë në kundërshtim me interesat e disa qendrave të fuqishme. Njerëzit që mund ti shfrytëzojnë si burime, tani më numërohen në gishtat e një dore ndërsa të tjerët i kanë të ndaluar si të papërshtatshëm...

Një koleg u përpoq që me një fjali të na përshkruajë se si ndihet.

- Gazetari është nën rrethim. Në njërin anë është redaktori kryesor, në anën tjetër pronari, ndërsa rreth tij gjenden edhe pushteti, shpallësit, partitë - thotë ai.

Prej bisedës me kolegët, fitohet përshtypja se ato janë të detyruar që përditë të fshehin informata, të mos i shohin "ngjarjet", të heshtin për tema pasi që e kanë të qartë se vetë vazhdimi me shkrim thjesht nuk do e kalojë filtrin redaktues ose po, në rast se publikohet, mund ta humbin edhe vendin e punës.

- Praktikoj autocensurë, si marrëveshje "e heshtur" me vetveten, për shkak të pasigurisë të vendit të punës, respektivisht për shkak të mundësisë që për arsyen edhe më banale të mbetet pa punë, a edhe më shumë, për shkak të frikës së arsyeshme se është shumë vështirë, pothuajse e pamundur të gjetet punë tjetër. Thjesht, nuk propozoj tema për punën e dikujt nga pushteti, për shkak se e di se, si e para, nuk mund të përpunohen, si e dyta, nuk do të botohen - thotë një gazetare e cila prapa vetes ka përvojë pune të gjatë në disa medime të shtypura maqedonase.

Një koleg i cili karrierën e vetë disa dekadash, e ndërtonte si gazetar në disa televizione nacionale, thotë se për momentin politikë redaktuese të ngjashme kanë disa medime dhe se atje është "e rrezikshme" të ketë tema dhe kontribute që mund ta çrregullojnë, siç thotë fotografinë "idile" të shoqërisë maqedonase. Ai pohon se redaktorët, respektivisht filtri i parë që tema të arrijë te publiku, aspak nuk i dëgjojnë gazetarët nëse nuk u konvenon ajo që ato e propozojnë për punë. Në këtë mënyrë, në fakt, sqaron kolegu, u tregojnë se tema e tyre nuk është e vlefshme për botim, gjë që në fakt e nxit autocensurën.

- Këndi i përpunimit është përfundimisht i ngushtuar, për një arsye të thjeshtë që pothuajse pa përjashtim, e di se nëse e propozon atë më të gjerin të mundshëm, për këtë nuk do të jesh as i dëgjuar e ku më të debatosh për argumentet e tua për shkak se konsideron se duhet të përpunohet ajo temë. Zgjedhja e

bashkëbiseduesve është "plagë kanceri"... Ka të përshtatshëm dhe të papërshtatshëm. Për arsye se nuk mundën ta durojnë betejën me argumente pasi ai dhe ai duhet të japin qëndrim, atëherë shkohet pas vijës së rezistencës më të vogël, në stilin "hajde ta lëmë këtë për tjetër herë" ose po me arsyetime të ngjashme - thotë gazetari.

Edhe një gazetare e cila vite me radhë mbulon tema të politikës së jashtme, pohon se në kohën e sotme nuk është lehtë të propozosh temë dhe të përpunosh tekst.

- Po, jam e prirë për autocenzurë, fillimisht gjatë propozimit të temave, por më së shumti për bashkëbiseduesit dhe për këndin, pasi ka një lloj "ndalese" për bashkëpunëtorë të caktuar (a nuk janë pak) - pohon kjo gazetare.

Një gazetar tjetër në një medium të shtypur, na e shpjegon metodologjinë e tij personale mbi të cilën i mendon temat.

- Në bazë ditore, zgjedhja se cilat tema ti autocenzuroj vjen prej bisedave me redaktorët me të cilët kam punuar. Për shembull, nëse në ndonjë mbledhje paraprake më kanë dhënë argumente ose kuaziargumente kundër ndonjë propozimi tim, ose po haptazi më kanë thënë se nuk është në interes të mediumit të shkruhet për këtë, normalisht se periudhën e ardhshme nuk do të propozoj diçka të ngjashme, përderisa mos

vlerësoj se është ndryshuar atmosfera dhe ka më pak kufizime për idetë - thotë kolegu ynë.

Asnjëherë si tani

Gazetaria maqedonase kurrë nuk ka qenë e liruar nga censura dhe autocensura, por të gjithë bashkëbiseduesit pajtohen se kurrë nuk ka qenë si tani. Arsyeja më së shpeshti e theksuar për atë se pse pikërisht këtë periudhë gazetarët gjithnjë e më shpesh e kanë atë ndjenjë është frika për mos e humbur punën deri te e cila, për shkak të gjendjes së tregut të punës, është vështirë të vihet.

- Prej përvojës sime 13-vjeçare, them se kurrë si tani nuk e kam pasur atë ndjenjë se autocensura dhe censura janë gjithandej përreth nesh dhe se ne si esnaf jemi të pamundur në luftën me to - thotë kolegja e cila ka stazh të gjatë në mediumet e shtypura.

GAZETARËT, NË
MËNYRË TË
VETËDIJSHME,
HESHTIN PËR NGJARJE,
NUK PARASHTROJNË
PYETJE, NUK HAPIN
TEMA PROBLEMATIKE,
PËR ARSYE SE
TREMEN NGA AJO QË
MUND TË NDODHË

Ajo, nuk është e vetmuar në vlerësimin e këtyllë.

- Edhe pse autocensura është shenjë e gazetarisë maqedonase në tërë periudhën e Maqedonisë plurale (këtu e vendos edhe periudhën prej 3-4 viteve prej 8 shtatorit të vitit 1991 i cili, nëse krahasohet me periudhën aktuale, është periudhë e gazetarisë "skandinave" - sipas shkallës së demokracisë dhe lirisë...)... Kishte edhe periudha të tjera të errëta - do e kisha veçuar atë të luftës në vitin 2001, kur secili u barrikadua në folenë e vetë etnike por, përfundimisht, kjo sot është, thënë kushtimisht, periudha më e errët... - deklaroi një koleg i cili tani punon në një medium interneti.

Sipas Zhaneta Trajkovska nga Shkolla e Lartë për Gazetari, gazetaria maqedonase kurrë nuk ka qenë e liruar nga autocensura, për shkak se ajo çdoherë ardhka në pako me presionet politike dhe ekonomike nga pushtetarët lokal dhe nga redaksitë, me pasigurinë ekonomike të gazetarëve, me rregullat e çrregulluara etnike dhe me nënçmimin e profesionit gazetar i cili në fakt duhet të jetë reflektim i demokracisë në një shoqëri.

- Duket sikur te ne edhe me të vërtetë është reflektim i proceseve që zhvillohen në Maqedoni - tru të nënshtruar, frikë nga përditshmëria, burokratizimi i të gjitha marrëdhënieve politike dhe atak i opinionit me lajme të parëndësishme, të shpëlara nga thelbi dhe të përpunuara në mënyrë marketingu, lajme të cilat janë pothuajse të njëjta në së paku dhjetë medime - thotë ajo.

Frika nga dënimi, nga pushimi prej pune, bile edhe nga burgu

„Gazetari duhet të publikojë informata të sakta, të verifikuara dhe nuk do të fshehë të dhëna esenciale dhe të falsifikojë dokumente. Gazetari do i respektojë ligjet në vend por, nuk do të publikojë ose fshehë diçka që është në kundërshtim me interesin publik.“ Këto janë rregullat themelore të esnafit, që përmbahen në Kodeksin e sjelljes edhe të gazetarëve në Maqedoni.

Megjithatë, ngjarje të tëra mbesin të fshehura në numër të madh të medimeve në bazë ditore. Sikur nuk ka ndodhur aspak. Ekipet gazetare i mbulojnë, incizojnë deklarata e mandej në medium as edhe një fjalë për këtë. Për një pjesë të kolegëve me të cilët bisedonim është tërësisht e zakonshme të shkojnë në konferencë për shtyp, por mandej në redaksi tu thuhet se ngjarja nuk do të mbulohet. Dhe, ato pajtohen me këtë. Integriteti profesional për shumicën është luks të cilin nuk mund t'ia lejojnë vetes.

Kështu që, kolegja e cila për shkak të presionit ta pranojë tezën e redaktorit gjatë përgatitjes së temës për një ngjarje lartë aktuale, tezë që ka qenë në kundërshtim me atë të sajën, e ka humbur punën.

- Pasi që me muaj mbeta pa punë, kuptova se në këtë kohë të keqe për gazetarinë, mundet është më mirë të mos provokohet shumë, pasi luftën nuk mund ta bëjë secili në mënyrë individuale. Gjëja më e madhe që mund të bëhet është të largohesh nga puna, e kjo nuk është zgjidhje - thotë ajo.

Në situatë kur tregu i punës është i stërnginjur nga oferta, a me mbylljen e medimeve dhe me vunerabilitetin e tyre ekonomik, kërkesa është gjithnjë më e vogël, të mbetet pa punë do të thotë të mbetet pa mundësi për çfarëdo angazhim pune në periudhë më të gjatë.

Pasiguria ekonomike dhe siguria sociale nuk janë arsytet e vetme që i detyrojnë gazetarët "të mos provokojnë shumë."

Fakti se në Maqedoni, gazetari Tomislav Kezharovski përfundoi prapa grillave për tekst të botuar në të cilin gjoja se e ka zbuluar identitetin e dëshmitarit të mbrojtur, dërgon një mesazh shumë të fuqishëm dhe të qartë se pasojat nga shkrimi për ndonjë pushtetar politik, afarist ose i ngjashëm mund të jenë edhe më të mëdha se humbja e punës.

Rolin e vet e ka edhe frika nga padia për reputacion të dëmtuar, padi e cila për gazetarin, për redaktorin dhe për pronarin do të thotë dënim disa mijash në euro.

- Çdo person ka autoritet dhe për askënd nuk duhet të shpifet dhe të ofendohet pa dënim. Por, problemi qëndron në atë që në sistem gjyqësor si i yni, i cili pothuajse sipas rregullit gjykon në favor të pushtetarëve politik të pushtetit ose të afaristëve të afërm me qeverinë, gjegjësisht, kur nuk ka gjyqësi të pavarur, është logjike që gazetarët dhe pronarët e medimeve, të tremben se nëse shkruajnë diçka kundër ndonjë pushtetari, do të duhet të paguajnë dëmshpërbim të madh - komenton redaktori i një mediumi.

Autocensura si zëvendësim efikas për censurë

Shumica e gazetarëve si arsye kryesore për autocensurën e theksojnë atmosferën e përgjithshme në redaksinë ku sundon plogështia dhe pasiviteti, ndërsa si nxitësit e saj të drejtpërdrejtë - redaktorët, më së shpeshti ato kryesorët, të cilët siç pohojnë janë vënë në atë pozitë nga ana e qendrave të fuqisë dhe u bëjnë trysni gazetarëve që të punojnë në vijën që ua kanë

SHUMICA E
GAZETARËVE, SI
ARSYE KRYESORE
PËR AUTOCENSURËN
E THEKSOJNË
ATMOSFERËN E
PËRGJITHSHME NË
REDAKSI, KURSE SI
NXITËS TË
DREJTPËRDREJTË TË
SAJ, REDAKTORËT

vizatuar ato. Kjo nënkupton se para këtij filtri të parë nuk mund të kalojë asnjë temë që nuk u përgjigjet ca strukturave.

-Të gjithë të ndërlidhur në një sinergji të pashkëputshme - pronari i cili është i varur nga pushteti, për arsye se ajo nuk do i drejtojë paratë nga reklamat te mediumi i tij ose po do i sugjerojë ndonjë qendre tjetër të fuqisë ekonomike kur do i ndajë paratë për marketing dhe për pi-ar, ta harrojë mediumin konkret. A, nuk bëhet fjalë për pak para - por për shuma milionëshe. Kup-tohet, në euro... Dhe, kur gjithë këtë do e shikoni nga një perspektivë anësore, dikush e quan edhe objektive - do e keni të qartë se si prej një qendre, praktikisht hartohet politika redaktuese në mbi 90 përqind të medimeve - thotë kolegu.

Ndërsa kolegja thotë se nuk e di se kush qëndron prapa imponimit të asaj ndjenje, por e di se kush ia imponon më së shumti.

- Më së shumti për shkak të redaktorit, për shkak se, sipas përvojës së deritanishme, ai është pengesa kryesore për shumicën e temave që i propozoj unë - thotë kolegia.

Një bashkëbiseduese tjetër, sqaron se ndalesë konkrete nuk arrin prej askujt, por se dihet qartë se çka mund të punosh, e çka nuk mundesh.

- Thjesht, e di se cilat tema mund ti përpunosh dhe për të cilët funksionarë të qeverisë mund të shkruash, a për të cilat jo. Ndalesë të prerë nuk ka vendosur as redaktori, as pronari i mediumit ose drejtori - por, çdo gazetar e ka të qartë orientimin e mediumit në të cilin punon dhe kahet nëpër të cilat duhet të lëvizë - thotë gazetarja.

Rolin e vet e luan edhe ndarja e imponuar e gazetarëve në ato "patriotë" dhe "tradhtarë" nga ana e politikës ditore, njollosja e lehtë e gazetarëve që shkruajnë në kundërshtim nga pritjet e qendrave politike. Për këtë shkak, kolegët bëhen inertë dhe konsiderojnë se çfarëdo teme që do e kritikonte Qeverinë ose ndonjë veprim të saj, është në fakt proopozitare nëse e përpunojnë, do i vendosin te ato me etiketën "sorosoidë". Prandaj ato, në fakt edhe refuzojnë të hulumtojnë, të parashatrojnë pyetje provokative, ta mbikëqyrin në mënyrë kritike punën e institucioneve.

Redaktorët që pohojnë se edhe vetë e ndjejnë autocensurën, këtë dukuri e interpretojnë me arsye të ndryshme.

Një redaktor me përvojë tredëciesh thotë se prania e autocensurës në redaksitë është e pakontestueshme ndërsa arsyet janë të shumfishta. Ai thotë se bile edhe perceptimi i mediumit si "serioz" kontribuon në politikën redaktuese që të evitohen tema të caktuara siç janë skandale korrupsione. Arsyja e dytë është reputacioni i të ashq. medium shtetëror, medium në hap

me shtetin, i cili sipas dikujt duhet të kultivojë gazetari patriotike. Dalja nga linjat e perceptimit të atillë shkakton pasoja, prandaj gjatë redaktimit të gazetës e njeh autocenzurën, edhe pse arsyet i llogarit të pabaza.

- Nuk është e kontestueshme se gazetarët gjithashtu janë njerëz të rëndomtë dhe mund të jenë patriotë, por patriotizmi nuk guxon të jetë arsyetim i mediumit ose i gazetarëve për ti mbuluar, gjegjësisht për të mos shkruar për afera korrupsioni - thotë ai.

Sipas tij, arsye me ndikim të njëjtë janë biznes interesat e pronarit që janë detyrimisht të ndërlidhura me politikën.

- Edhe përsëri asaj që pronari kurrë personalisht nuk bën trysni, as që paraqitet personalisht, as dërgon mesazhe në lidhje me politikën redaktuese, është fakt se ka disa fusha për të cilat në mënyrë të heshtur është e qartë se janë interes i drejtpërdrejtë i pronarit dhe se ato tema nuk mund të hapen. Për fat, pak janë ato tema - thotë redaktori.

ËSHTË PROBLEM QË NË REDAKSITË KA NJERËZ TË CILËT GAZETARINË E PËRJETOJNË SI PROPAGANDË DHE QË KONSIDEROJNË SE ËSHTË KREJTËSISHT NORMALE TË KUJDESEN PËR INTERESAT E PARTIVE, TË PRONARIT OSE NDOJNË TË TRETIT, E JO PËR INTERESIN PUBLIK

Autocensura si arsyetim për joprofesionalizëm?

Por, përkundër përvojave të këtylla të gazetarëve, ka edhe redaktorë të cilët ankohen se edhe përsëri asaj që u japin tema gazetarëve, ato refuzojnë ti përpunojnë. Me arsyetim se tema është problematike dhe se mund tu shkaktojë probleme, ato e fshehin në inertësinë e

vet, për shkak se u vjen më vështirë të hulumtojnë ndonjë temë - thotë redaktori me të cilin bisedojmë.

- Censura, respektivisht censura e supozuar në mediumin për të cilin punojnë, është më shumë se arsyetim për to. Demek, redaktori ose kryeredaktori këtë nuk do e botojë, ashtu që nuk vlen të shkruaj për këtë, gjegjësisht të hulumtoj, a në fakt, kjo është vetëm kërkimi i arsytimit për shkak se nuk dëshiron ta hulumtojë temën. Kjo është autocensurim por joprofesionalizëm - thotë redaktori.

Problem plotësues është ai që në redaksitë ka njerëz që gazetarinë e përjetojnë si propagandë dhe që konsiderojnë se është tërësisht normale të kujdesen për interesat e partive, të pronarit ose të ndonjë të tretit, e jo për interesin publik. Kështu ndodh që kolegë të injorojnë lajme, ngjarje dhe informata.

Thjesht, bëhen sikur nuk ka ndodhur asgjë, nëse lajmet janë të ndërlidhura me konkurrentët politik ose afarist të pronarit të tyre, bile edhe atëherë kur vetë ai nuk ka asnjë dëm prej botimit të tyre.

Edhe Trajkoska konsideron se pjesa më e madhe e gazetarëve e kanë pranuar rolin e vet të jenë zëdhënës të politikës, të partive të pushtetit dhe të opozitës, të të fuqishmëve ekonomik, të elitës intelektuale të deformuar dhe i të gjithëve prej të cilëve siç thotë, mund të fitojnë diçka ose të cilët mund të kenë ndikim mbi të ash.q. karrierë të tyre.

MN: Përgjegjësi dhe të drejta pune si armë kundër autocensurës

Përvoja tregon se për dallim nga censura e cila është e dukshme, e drejtpërdrejtë dhe e shtrenjtë për një aparat shtetëror represiv, autocensura është shumë më e rrezikshme, më e poshtër dhe shumë më efikase. Prania e saj është konfirmim se në gazetarinë maqedonase akoma nuk ekziston përgjegjësi profesionale dhe kjo varet drejtpërdrejtë prej qendrave të fuqisë së biznesit dhe të politikës.

- Në kushte të këtilla as që flasim për autocensurë, ose për informata gjithëpërfshirëse dhe profesionalisht të përpunuara që duhet qytetarit t'ia bartin realitetin dhe ti lënë hapësirë që vetë të vendosë për vete. Shkalla është vendosur më poshtë, kjo është faza e trurit të nënshtruar dhe shpirtit të robëruar, gazetaria pothuajse edhe nuk ekziston - thotë Zhaneta Trajkoska.

Ajo nuk është aspak optimiste se diçka mund të shkojë në të mirë. Konsideron se përpjekjet e gazetarëve për mbajtjen e standardeve profesionale do të shuhen, për arsye se nuk ekziston bazë mbi të cilën mund të mbijetojnë.

Por, pa dallim në pesimizmin, është e qartë se autocenzura si plagë kanceri e gazetarisë doemos të zëvendësohet me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Vetërregullimi, si mbrojtje e transparencës, por edhe e esnafit nga gazetaria e keqe dhe joprofesionale është pjesë e zgjidhjes.

Kuptohet se ajo nuk do të jetë e mundshme në rast se gazetarët vazhdojnë të punojnë në kushte të pasigurta të punës. Vetëm gazetar i paguar në mënyrë[dinjitoze i cili nuk trembet se në çdo moment mund të pushohet nga puna, mund të dënohet për ofendim ose edhe më e tmerrshme, të arrestohet, është në gjendje ta respektojë parimin themelor të profesionit - të informojë për të vërtetën.

Frosina Dimeska

Ashu siç thotë në mënyrë të përshtatshme Taçko Llokvenc, në librin e tij Lajm dhe pushtet, "ekziston fakt se në vendet ku është e përhapur liria e shtypit, disa punë të rëndësishme nuk mund të lexohen publikisht, për shkak se gazetaret janë aq të lira që thjesht "punët e atilla", nuk i botojnë. Domethënë, edhe robëria personale nga interesi mund të quhet dhe quhet liri!" Prej kësaj mund të përfundojmë se problemi i autocensurës është një nga më të ndërlikuarit në gazetarinë bashkëkohore, edhe atë pikërisht për shkak të faktit që ai aspak nuk perceptohet si problem, por si diçka që është tërësisht normale. Thelbësorja të kjo dukuri negative, veçanërisht në rrethanat maqedonase, është ajo që gazetari-autor i tekstit të caktuar, i kontributit, storjes, fotografisë dhe ngjashëm, trembet të publikojë ato, për shkak të frikës nga pasojat, që mandej do të vijonin ndaj jetës së tij, trupit, shëndetit, karrierës, punës, familjes ose po ndaj ekzistencës së tij, gj.gj. stabilitetit financiar. Sido që të jetë mënyra dhe cilët do që të jenë motivet për të, autocensura është vetëm një nga format e shumta të ndryshme, më pak a më shumë suptile të censurës - e cila pra është në mënyrë më të rreptë dhe të prerë e ndaluar me Kushtetutën tonë (Neni 16, paragrafi 7 i KRM). Respektivisht, liria e bindjes, ndërgjegjja, mendimi dhe e shprehura publike e mendimit janë "katër të drejtat e shenjta" në sistemin tonë juridik për të cilin është kompetent

Gjykata kushtetuese e RM dhe mund të procedojë sipas parashtresës së qytetarit in concreto (Neni 110, paragrafi 1, alineja 3 e KRM) – por, për fat të keq, deri tani në historinë kushtetuese juridike dy dekadash të Maqedonisë së pavarur, kjo nuk ka ndodhur.

Kahet për tejkalimin e kësaj situatë katastrofale do të duhej të lëvizin kah vetorganizimi sa më i madh i mundshëm dhe kah vetërregullimi i esnafit gazetar; kah ngritja morale dhe guximi i çdo gazetari që të

refuzojë "propozim të pakëndshëm" të caktuar në zëvendësim për dobi personale, duke u udhëhequr fillimisht prej interesit shoqëror publik; si edhe me përmirësimin e mekanizmave juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte kyçe, që është shtylla e çdo shteti demokratik dhe juridik. Duke i ndjekur kahet zhvillimore krahasuese - juridike, mundet duhet seriozisht të mendohet edhe për vendosjen e institutit padi kushtetuese me të cilën gazetarët e prekur, të cilët janë viktimat e censurës, do të mundën më shpesh të kërkojnë mbrojtje të të drejtave të veta drejtpërdrejt prej Gjykatës kushtetuese, siç është më rasti me ca vende në rajonin tonë, konkretisht, në Slloveni.

KOMENT JURIDIK



Ndërmjet mbylljes dhe censurës

Na duhen përafërsisht 50 minuta dhe dy autobusë deri në shtëpinë e Vesnës, në një lagje periferike shkupjane. Ajo udhëton çdo ditë aq kohë deri në Qendër, ku gjendet mediumi në të cilin punon. Emri i saj është i trilluar kurse Vesna është pseudonimi me të cilin e emërojmë gazetaren në storjen tonë e cila preferoi të flasë në mënyrë anonime. Ajo punon në medium të pavarur i cili vlen për kritik ndaj punës së qeverisë.

- Kurrë nuk kam folur në mënyrë anonime për qëndrimet e mia por qe, tani do të bëj përjashtim – shpjegon Vesna, derisa udhëtojmë së bashku deri në shtëpinë e saj për ta dëgjuar storjen e saj.

- Nuk e di si t'ju them, njeri thjesht turpërohet prej varfërisë – na thotë ajo.

Nuk kaluan as 15 minuta të kësaj bisede të zhvilluar në këmbë në autobusin e stërngarkuar, kur kuptuam se për çfarë është duke folur. Shtëpia e saj, në fakt as nuk është e saj. Vesna vjen nga brendia e

Maqedonisë dhe paguan qira së bashku me mikën e saj e cila është cimere e saj qysh prej ditëve studentore dhe me të cilën kanë ndarë shtretër nëpër shtëpitë studentore të Shkupit. Kanë marrë me qira një kat të një shtëpie. Mobicet janë aq të vjetërsuara që pothuajse edhe nuk ka dollap ose derë në të cilin ka mbetur bravë ose dorëz. Jetojnë në 45 metra katrorë. Njëra prej tyre fle në dhomën e ashtuquajtur të gjumit, e cila në fakt posedon edhe krevat për fëmijë, dollap të vogël për veshje, qilim me vrime, masë të vogël, kurse kolegja jonë fle në dhomën e ditës. Muret me erë lagështie i ndajnë të dyja.

- Nuk mund t'i lejoj vetes diçka më të shtrenjtë se kjo. Prandaj

MEDIUMET
KRITIKE DHE
GAZETARËT QË
PUNOJNË ATJE
PËRJETOHEN SI
"ARMIQ
SHTETËRORË"

edhe jetoj në lagje periferike. Familja ime nuk ka që të më dërgojë para, a edhe nuk dua të kërkoj, kam 28 vjet dhe do të ishte turp. Qiraja këtu është 70 euro, kurse në Qendër ose po në Aerodrom, për hapësirën e njëjtë do të duhet të paguajmë së paku 160 euro për të dyja. Edhe këto 35 janë shumë për mua – na thotë Vesna.

Paga e saj është 12 mijë denarë. Pothuajse pesë vite punon si gazetare në medium të shkruar.

- Prej kur kam filluar të punoj, deri në muajin e fundit, isha me honorar. Kontratën autoriale e nënshkruanim çdo muaj. Asnjëherë nuk di në çka je, nuk e di nëse muajin e ardhshëm do ta vazhdojnë kontratën ose jo – rrëfen gazetarja e re dhe shton se edhe ajo që është karakteristike në rastin e saj është ajo që ajo edhe ka mirëkuptim për situatat në të cilat punon.

- Në mediumin paraprak ku punoja, varesha prej mëshirës së punëdhënësit, në këtë medium, thjesht edhe ne së bashku me punëdhënësin jemi lënë në mëshirë dhe pamëshirë. Nuk ka para te mediumet kritike. Nuk ka reklama, vetëm ca donacione më të vogla prej të cilave mezi mbijetohet. Nuk kam as kë të akuzoj për situatën time, përveç mundet pushtetin, i cili e solli esnafin deri në këtë pashpresë – rrëfen ajo derisa na përgatitu kafënë në bocën e gazit.

- Doemos të kursehet. Dimër është. Me hyrjet e mia, çdo ditë e kam të përlloritur. Ngrohim kur kthehem prej pune, natën nuk ngrohim, domethënë vetëm nga disa orë në ditë, derisa të na zërë gjumi.

Vesna thotë se në fillim të karrierës së saj, aspak nuk i ka penguar që ka qenë me honorar. Ka qenë i mjaftueshëm fakti që punon si gazetare, diçka që e ka pasur dëshirë qysh prej viteve të shkollës së mesme – të ndikojë mbi shoqërinë, të sjellë ndryshime, ta informojë opinionin, të hulumtojë. Kështu, aspak nuk ka qenë faktor vendimtar fakti nëse është ose nuk është e paraqitur.

- Kur fillova të punoj, na kushtëzuan, buxheti për paga është kaq. Dëshironi tu paraqesim ose të jeni me honorar dhe tu hiqet vetëm dhjetë përqind tatim personal, ashtu na pyetën. Unë e di se mediumi im nuk ka para tjera dhe thashë, mirë, me honorar, për mua është çdo denar i rëndësishëm – thotë Vesna. Por, më vonë ka kuptuar çfarë do të thotë të jesh punëtor i paraqitur me sigurim shëndetësor dhe personal të paguar, kur është sëmurë seriozisht. Gjatë kërkimeve që është dashur të bëhen për të zbuluar se çka është jo që i shkakton vështirësitë e saj të përditshme, e harxhuaka një të tretën e pagës disa muaj. Kjo është bërë e padurueshme dhe i ka lutur shefat e vet të gjejnë mënyrë ta paraqesin.

- Tani, pagën e kam më të ulët, por nuk e ndiej këtë për arsye se paratë që paraprakisht i jepja për mjekë, tani nuk i jap. Edhe përkaj çdo gjëje, unë nuk mundem dhe nuk dua ta akuzoj mediumin në të cilin punoj. Unë kam mirëkuptim për të gjithë kolegët të cilët puno-

jnë me honorar nëpër mediumet që në përgjithësi mbijetojnë nga donacionet modeste dhe kanë pranuar status me honorar në emër të pagës pak më të lartë, dhe kur them pak më të lartë, mendoj dhjetë, 12, 14 ose më së shumti 18 mijë denarë në ca mediume. Opsionet, gjithandej, bile edhe nëpër mediumet proqeveritare, janë ato – të jesh i punësuar është thjeshtë privilegj i madh – rrëfen Vesna.

Vesna thotë se për momentin, frika e saj më e madhe është sëmundja. Nuk e tremb edhe aq fakti që ditëve kah fundi i muajit, para pagës, mbet e uritur ose vetëm me një haje modeste në ditë. Droja e saj është se edhe kjo që e ka tani si gazetare, që në muajin e ardhshëm, mund të mos e ketë.

PAGAT,
NËSE KA,
JANË TMERRSHËM
TË ULËTA.
HYRJE NUK KA,
KURSE FRIKA
NGA PROCESIT
GJYQËSORE
ËSHTË E MADHE

- Vazhdimisht mbyllen mediume. Këtu, në redaksinë tonë, çdo ditë është e pasigurt, nuk dihet deri kur do të kemi mjete të punojmë dhe nëse donatori do na aprovojë edhe ndonjë projekt ose nuk do të ketë para. A, e dhe ato projekte nuk janë të larta, me sa kam dëgjuar, lëvizin prej 20-30 mijë euro në vit. Hajde pra, bëni një medium me ato para dhe mbijetoni 12 muaj – thotë Vesna.

Për vete thotë se nuk dëshiron ta shohë veten si të varfër, edhe pse të gjitha parametrat e vendosin a të në atë kategori të qytetarëve.

- Kam parë halle edhe më të mëdha se të mijat dhe padrejtësi më të mëdha se këto. Kjo është kjo. Jeta e shumë kolegëve të mi është mizore, besoni. Edhe ne, jemi disi të pajtuar me këtë. Ose kjo ose punë në medium qeveritar, nën kontroll. Por, edhe atje reporterët nuk jetojnë shumë mirë, së paku jo ato “të mortshmit e rëndomtë”, që nuk janë redaktorë – thotë Vesna.

Dhe, me të vërtetë, fati i Vesnës nuk është unik. Fatin e saj e ndajnë shumë kolegë të saj, kurse punët, së paku sipas përshtypjeve të shumicës, bëhen gjithnjë më të këqija e më të këqija.

Kritikët janë armiqtë shtetërorë

Shumica e gazetarëve do të thonë se viti 2011 është një nga vitet më të zeza për mediumet në Maqedoni – viti kur u mbyllën gjithsej pesë mediume. Në korrik të vitit 2011, u mbyll televizioni parë i pavarur në vend dhe me siguri mediumi me ndikim më të madh, televizioni A1, si edhe gazetat “Vreme”, “Shpic” dhe “Koha e re”. Të gjitha ishin në pronësi të Velija Ramkovskit, i cili sot është në burg dhe të gjithë ishin të prirë në mënyrë kritike ndaj politikave të Qev-

erisë. Ramkovski ishte dënuar për krim financiar dhe për abuzim tatimor, por në raportin e Komisionit evropian shprehej shqetësim për shkak të qasjes seleksionuese në procedurë. Vetëm prej këtyre medimeve mbetën në rrugë rreth 500 gazetarë dhe punëtorë mediami.

Prej atëherë e kënde, numri i gazetarëve të papunësuar është në rritje. U mbyllën javoret “Forum”, “Globus” dhe “Gragjanski”, gazeta ditore “Den”, televizioni AB, televizioni A2, u abroguan TV projekte. Me ndryshimet në politikat redaktuese në favor të politikës qeveritar, në plotësim u përjashtuan nga puna gazetarët të cilët e mbanin epitetin “kritik” edhe në mediumet si “Utrinski vesnik”, televizioni Alfa dhe të tjera. Organizatat ndërkombëtare të cilat merren me çështjet e lirisë të fjalës, informonin se më shumë se 800 gazetarë dhe punëtorë mediami kanë mbetur pa punë prej vitit 2011 e kënde në Maqedoni.

Ato për të cilët nuk kishte vend askund ishin gazetarët kritik ose ato gazetarë të cilët refuzonin të ekzekutojnë detyra partiake. Disa prej tyre, të cilët akoma kishin punë, provonin ti durojnë trysnitë në mediumet në të cilat punonin a të cilët gjatë natës i ndryshonin politikat redaktuese, ndërsa ato tjerët bën përpjekje të grupohen në vendin e vetëm që mbeti i lirë – në internet. Disa prej tyre, me emër e mbiemër, kurse disa, në mënyrë anonime i ndanë përvojat rreth udhëheqjes dhe punës në medium të këtillë. A shumica prej tyre dhe të punësuarit e tyre e ndajnë fatin financiar të Vesnës.

Predrag Petroviq fillon të punojë si gazetar në servilin publik RTVM në vitin 1997. Starton si reporter, a mandej bëhet edhe redaktor dhe udhëheqës në këtë televizion. Në vitin 2002, transferohet në televizionin privat A1 ku mbetet deri në mbylljen e televizionit në vitin 2011. Vitin e njëjtë fillon të punojë në gazetën e re ditore “Fokus”, që në fund të vendosë ta formojë me një grup kolegësh, portalin informativ A1on.

- Për shumicën prej nesh, veçanërisht ato që vinin nga televizioni i mëparshëm A1, nuk kishte vend askund. Nuk ishte me rëndësi nëse ke shkathtësi, përvojë dhe njohuri, nuk ishte me rëndësi nëse je i mirë ose jo, thjesht, gazetarët e A1 ishin si murtajë prej të cilës secili ik, ne e mbanim etiketën “armiç të shtetit”. Ne ishim të detyruar që vetë ta kërkojmë vendin nën diellin, nëse dëshironim të punojmë në mënyrë të pavarur dhe profesionale dhe të mbesim kritik ndaj punës së Qeverisë – thotë Petroviq.

Ai thotë se nëse nuk ishin donacionet, mediami i tij nuk do të ekzistonte. Por, edhe me to, mezi lidhet njëri skaj me tjetrin, për shkak se siç thotë, tregu i medimeve udhëhiqet prej ideologjive, e jo prej biznes logjikës.

- Reklama pothuajse nuk ka, kompanitë e mëdha dhe të mesme, në pjesën më të madhe na bojkotojnë, për arsye se siç thonë, trem-

ben nga inspektimet nëse merret vesh se qe, na ndihmojnë ne me reklama. Nuk është me rëndësi a je cilësor ose të lexojë, me rëndësi është se si të sheh ty pushteti. Ndërsa, agjencitë e marketingut, haptazi thonë se nuk guxojnë as të paramendojnë të lëshojnë reklama te ne – thotë ai.

Me të pajtohet edhe Semi Mehmeti, redaktor i mëparshëm në gazetën ditore “Koha e re”. Ai tani e ka portalin në gjuhën shqipe, “Alamakos”. Thotë se, nëse nuk ishin donacionet modeste, ai aspak nuk do të ketë medium.

- Them, donacione modeste, për shkak se, më tregoni ju a mund të bëni medium me buxhet prej një mijë deri në tre mijë euro në muaj, e ku më diçka serioze!? Reklama nuk ka. Kompanitë që në

mënyrë tradicionale reklamohen, ne na evitojnë, besoni se është tërësisht njësoj edhe në bllokun shqiptar. Një kompani e madhe dhe e pasur e liroi zemrën dhe filloi të reklamohet te ne dhe paramendoni, na paguan 150 euro në muaj. Kurse në portalet proqeveritare reklama e njëjtë kushton 500 dhe më shumë euro në javë. Kjo është ndihmë sociale, jo reklama – thotë Mehmeti.

Në “Alamakos” punojnë gjashtë gazetarë. Mehmeti është edhe gazetar, edhe redaktor edhe pronar. Të punësuarit e tij, thotë ai, pranojnë pagë shumë më të ulët se ajo mesatare.

- Çfarë page mesatare, pagat janë shumë nën të, janë mizore. Edhe për mua, edhe për ato. Unë kisha dashur që të gjithë të paguhen në mënyrë dinjitoze, e

jo të jetojnë në pragun e varfërisë, por nuk ka zgjidhje. Ose duhet të jem VMRO ose BDI, që të rrjedhin reklama qeveritare ose po të luftoj për projekte shumë vjetore e të cilave janë më të ulëta se hyrjet mujore të ca portaleve proqeveritare rrëfen i dëshpëruar Mehmeti.

Mehmeti thotë se gazetarët e tij, njësoj si edhe ai, e dinë se si qëndrojnë punët – ose shkon kah më e mira dhe je i kontrolluar ose punon lirshëm, por në varfëri, dhe pret që të vijë ditë më të mira për gazetarinë.

Përditshmëri me frikë dhe pasiguri

Xhelal Neziri, kryetar i Qendrës për Gazetari Kërkimore – Shkup Maqedoni, thotë se gjendjet në mediumet e pavarura shqiptare

ORGANIZATAT
NDËRKOMBËTARE
QË MERRN ME
ÇËSHTJET E LIRISË
SË FJALËS
INFORMUAN SE MË
SHUMË SE 800
GAZETARË DHE
PUNËTORË MEDIUMI
KANË MBETUR
PA PUNË PREJ
VITIT 2011
E KËNDEJ

mundet janë edhe më të këqija, për arsye se ato, jo vetëm që luftojnë me portalet maqedonase përmbajtjet e të cilave i lexojnë edhe shqiptarët, por edhe me mediumet nga Kosova dhe Shqipëria, të cilat janë gjithashtu të pranishme këtu dhe u konkurrojnë.

- Siç pritet, e gjithë kjo reflektohet edhe në pozitën sociale të gazetarëve, të cilët gjithnjë e më shumë duan të gjejnë dalje nga ky profesion përmes kërkimit të punës në fushat tjera. Edhe vetë gazetarët janë të vetëdijshëm se mediumi në të cilin punojnë ose vetë pronarët nuk mund tu ofrojnë kushte më të mira, qofshin ato të garantuara me ligj se jo – thotë Neziri.

Biljana Petkovska nga Instituti Maqedonas për Medime, thotë se ato i përcjellin gjendjet dhe përfundimet e tyre janë se të njëjtat ndikojnë seriozisht edhe mbi cilësinë e punës.

- Shumë shpesh pagat e tyre janë nën çdo dinjitet profesional, dhe nuk mund të krahasohen me asnjë vend në rajon. Kushtet në të cilat punojnë janë alarmuese. Pagat e ulëta, pasiguria në vendin e punës dhe frika e vazhdueshme nga humbja e punës, kontribuuan që gazetaria të shndërrohet në një nga profesionet më së paku të preferuara dhe të respektuara në vend – thotë Petkovska.

Një gazetar në një nga portalet e pavarura, i cili dëshironte të mbesë anonim, thotë se në redaksinë e tij pothuajse të gjithë janë me honorar, kurse pagat i kanë ndërmjet 8 dhe 15 mijë denarë. Është i vetëdijshëm se nuk ka shumë para në një medium të atillë, por ajo që i pengon më së shumti është që gjendja financiare e atyre medimeve ndikon seriozisht mbi procesin e punës.

- Redaksia nuk ka para të paguajë taksë ose lëndë djegëse, ashtu që në intervista ose konferenca të shtypit shkoj në këmbë. Nuk kemi para as për fotograf, ashtu që vetë ne jemi edhe fotoreporterë. Për lektorë as që bëhet fjalë, ashtu që shpesh dalin tekste me gabime. Kompjuterët në punë ishin donacione, gjithashtu edhe byrotë. Strukemi në zyra tmerrshëm të vogla, nuk kemi as frigorifer, ziejmë kafe në bocë me gaz, a para do kohe fituam edhe printer, e ku më diçka tjetër – thotë ai.

Petroviq pajtohet se internet mediumet mezi kënaqin disa standarde profesionale, a për diçka më serioze si gazetaria kërkimore, mezi bëhet fjalë.

- Ka ditë kur nuk mund të paguaj as taksë për ndonjë gazetar të shkojë në terren. Nuk mund të punohet gazetari kërkimore nga zyra. A mezi mundet edhe gazetaria informative. Gazetarët e mi punojnë gjithçka, përcjellin gjithçka, ne nuk mund t'ia lejojmë vetes luksin të kemi gazetarë të specializuar, të kemi redaksi ekonomike, politike ose të jashtme. Ne jemi disa veta të cilët japin gjithçka prej vetes që të mund ta punojnë atë që e duan në mënyrë të ndershme dhe të marrin ndonjë denar – thotë Petroviq.

Autocensura: Kur frika e ruan vreshtin

Meri Jordanovska është gazetare në javoren “Fokus”, pronari i së cilës, Nikolla Mlladenov e humbi jetën pranverën e kaluar në aksident komunikacioni në rrethana të dyshimta. Pas vdekjes së tij, u shuajt gazeta ditore “Fokus”, e përkohësisht ishte ngrirë edhe javorja “Fokus”. Jordanovska dhe kolegët e saj, jetonin disa muaj në pasiguri për atë nëse javorja e cila, edhe para vdekjes së Mlladenovit ballafaqohet me vështirësi financiare, do të vazhdojë të botohet ose jo. Në gusht të vitit të kaluar, “Fokusi” më në fund doli por edhe ato e kanë fatin e kolegëve të tjerë nga mediumet e pavarura kritike – pak reklama dhe donacione modeste. E gjithë kjo, thotë Jordanovska, i pengon të punojnë në mënyrë cilësore.

MEDIUMET E
PAVARURA
SHQIPTARE,
LUFTOJNË JO VETËM
ME MEDIUMET
MAQEDONASE,
POR EDHE MË ATO
TË KOSOVËS
DHE SHQIPËRISË,
QË JANË KËTË TË
PRANISHËM
DHE GJITHASHTU
U KONKURROJNË

- Për shkak se tani jemi pak njerëz, financohemi nga donacionet dhe gjithçka është transparente, shumë qartë mund të kuptoj se pse kursehet në ngrohje, për arsye se kur shkojmë në rrugë, shohim që t’i shterim të gjitha storjet në atë qytet me qëllim që të mos harxhojmë para për benzinë dy herë... thjesht, nuk ka. E si të përpunoni storje serioze nëse nuk keni para për dokumente, për udhëtime, nëse nuk keni kohë të cilën nuk mund tua japë mediumi, për shkak se edhe njerëzit si edhe paratë, numërohen në gishta. Thjesht, çdo gjë është improvizim – rrëfen ajo.

Por, ajo që të godet më së rëndi është autocensura. Zakonisht, censura është e ndërlidhur me mediumet proqeveritare, por mospasja e parave krijon një sërë problemesh edhe te mediumet kritike, duke fil-

luar prej frikës e përfunduar me autocensurën. Kur vazhdimisht jeni në goditje, frika prej padive është në rritje, diçka që më së miri e ka përjetuar në lëkurën e vet gazetari Emill Zafirovski, i cili karrierën e vet e filloi në “Dnevnik”, a mandej vijonin gazetatat ditore “Vreme” dhe “Nova Makedonija”, kurse tani punon në portalin informativ mkd.mk.

- Dhjetë vite zvarritem nëpër gjyqe. Më kanë gjykuar në mungesë, dhe mandej për aktgjykimet kuptoja prej përmbaaruesve, pasi do ma bllokoni llogarinë, pasi aktgjykimet bëheshin të plotfuqishme, kurse unë nuk isha aspak i informuar se jam dënuar. Vite me radhë, gazetaria është një nga profesionet më degraduese dhe më stresuese në vend, kurse për momentin edhe një nga më e papaguara. Një pjesë e madhe e gazetarëve nuk janë të paraqitur, pagat nuk i kanë të rregullta, por prandaj janë rregullisht të ekspozuar në padi nga ana e bartësve të funksioneve publike, me ç’rast nuk kanë asnjë mbrojtje

juridike – thotë Zafirovski.

Me situatë të ngjashme për momentin është ballafaquar javorja “Fokus”. Siç qëndrojnë punët tani, në kontestin gjyqësor që e ngriti kundër tij drejtori i Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, Sasho Mijallkov, redaktorja e “Fokus”-it, Jadranka Kostova duhet të paguajë pesë mijë euro, kurse gazetari Vllado Apostollov një mijë euro, së bashku me harxhimet gjyqësore, gjithsej duhet të paguajnë nëntë mijë euro, shumë që as për së afërmi nuk mund t’ia lejojnë vetes punëtorët mesatar të mediemeve. E gjithë kjo shtiu frikë edhe të kolegët e tyre. A të botohet diçka që ka qenë ndërlidhur me Mijallkovin, është nën pikëpyetje në çdo redaksi, pa dallim se sa edhe në të të sundojnë pavarësia, objektiviteti dhe profesionalizmi. Megjithatë, ekzistenca e mediumit vihet në pyetje. Së paku ashtu flet përvoja e gazetarit nga një redaksi maqedonase, i cili në mënyrë anonime na i tregoi frikët e veta.

- Kisha storje të mirë për drejtorin e DSK Sasho Mijallkov. Drejtori im, i cili është edhe gazetar, më tha se nuk mund ta botojë, për arsye se trembet nga paditë, më thoshte: shiko si përfunduan Jadranka dhe Vlladoja. Shkruaj çfarë t’duash, kjo nuk mundet! E njëjta ka ndodhur edhe me storje tjera, thjesht më thotë, nëse na padit do të humbim bile edhe nëse kemi të drejtë, ne nuk na duhet dënim prej 27.000 euro dënim, mjaftojnë 5.000 euro dhe ne do të duhet menjëherë të mbyllemi. Prandaj, kritiko por në mënyrë të matur – rrëfen një gazetare nga një ueb portal.

Ajo thotë se edhe vetë ka rënë në kurthet e autocensurës, pa i thënë askush asgjë.

- Do të gjej ndonjë storje që e prek dikë nga top funksionarët dhe i them vetes, hajde hiq dorë, edhe përsikaj kësaj, në punë mundet nuk do më lejojnë, kush do të shkojë mandej nëpër gjykata. Ne, nuk i shqyrtojmë më dobësitë e storjeve tona, nuk themi, mirë, këtu kam prova dhe mund ta botoj këtë, a atje nuk kam dhe nuk do të botoj. Ne kemi një parametër – gjyqësi të kontrolluar. Nëse storja për korrupsionin është e ndonjë funksionari të eshalonit të tretë, mund të shkojë, nëse është për ndonjë nga eshaloni i parë ose i dytë, nuk angazhohemi aspak – thotë gazetarja dhe shton se paditë ndaj “Fokus”-it por edhe rastet tjera në të cilat gazetarët kanë qenë të gjykuar, kanë qenë “leksion edukativ” i mirë për të gjithë.

Sami Mehmeti, nga “Alamakosi”, pohon se ato nuk tremben të botojnë skandale, por pohon se në rast se vjen deri te padia, ai nuk ka mjete për ti mbrojtur gazetarët, as veten, as mediumin.

- Kush më garanton mua drejtësi gjyqësore!? Të gjithë pra shikojmë se çfarë po ndodh, nuk jemi të marrë. Nuk kemi para as për pagesën e dënimeve, as për avokatë – thotë Mehmeti.

Momentalisht, Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punëtorëve të mediumit siguron mbrojtje juridike për gazetarët e paditur, njësoj

si edhe SHGM, a ndonjëherë disa prej avokatëve vetë i ofrojnë shërbimet e veta falas, duke e ditur se në çfarë gjendje të keqe janë mediomet kritike.

Pasi hyri në fuqi dekriminalizimi i shpifjes, ligji i ri parashikon dënime për mediumin prej 15.000 euro, 10.000 për redaktorin dhe 2.000 për gazetarin.

- Gjendja e këtillë krijon kulturë të censurës dhe autocensurës nëpër redaksitë edhe te vetë gazetarët, censurë në redaksitë dhe te vetë gazetarët, mungesa e etikës nëpunës dhe humbja e interesit për hulumtime gazetare të temave të cilat i observojnë në mënyrë kritike gjendjet në shoqëri. Me këtë, stigmatizohet në mënyrë strategjike de demisionohet roli dhe funksioni shoqëror i gazetarisë dhe profesionit gazetar dhe relevanca e saj si korrektor i proceseve – thotë Biljana Petkovska nga IMM.

Vesna, gazetarja nga storja jonë rrëfen se para vitit 2010, kur gazetaria sado pak sipas saj, ka qenë “më normale”, ëndrra e saj ka qenë të nënshkruhen marrëveshje kolektive në esnafin e saj dhe të fillojë të funksionojë sindikata.

-Ëndrra për sindikatë na u realizua, edhe pse ai nuk mundet pa bashkimin tonë. Por, ëndrrën për marrëveshjen kolektive e harrova. Ne pra jemi të detyruar të marrim pushime vjetore më të vogla, për arsye se thjesht jemi pak njerëz në punë, paramendoni edhe një obligim të atillë të kenë këto medime. Ironi e madhe. Thjesht, nuk ka rrugëdalje – thotë Vesna.

Shpresa nuk lejon të lakohet kurrizi

Megjithatë, ka shpresë. Së paku, ashtu thotë Ida Protuger, gazetare momentalisht e papunësuar, e cila pohon se edhe përkaj gjitha trysnive dhe shtrëngimeve, nuk do të lejojë ta lakojë kurrizëin.

- Kur keni vendosur të merreni me gazetarinë, apriori e dini se ky profesion është i stresuar, ka betejë konkurrencte të jeni i pari, të kontrollohet ndonjë informatë, kenë përgjegjësi para shikuesve dhe lexuesve. Por, kjo është pjesa e këndshme e punës. Ajo që me të vërtetë është frustuese dhe të cilën vështirë e pranon çdo gazetar i cili ka hyrë në profesion e qëllime të ndershme dhe i përmbahet integritetit të vet, janë presionet në vetë ambientin e punës, prej këshillave “miqësore” deri në censurë. Jam ballafaquar disa herë me pasiguri dhe me frikë se do e humb punën dhe ato periudha stresuese nuk harrohen – thotë Protuger.

Megjithatë, një ndodhi para do kohe ia ka kthyer besimin se mundet ka shpresë të tejkalohet ky tranzitim i vështirë në fushën e medimeve, nëse gazetarët vetë angazhohen ta mbajnë integritetin e vet.

- A jam më e lumtur kështu? Unë po, edhe pse, më duhet patjetër

të mendoj se si do e siguroj pagën dhe se mundet kjo nuk do të jetë e mundur në gazetari. Ose po do jetë, nëse ka më shumë njerëz me integritet, të cilët do u kundërvihen proceseve të dëmshme. Para do kohe dëgjova se kolegja ime, një nënë me asistencë, ka refuzuar honorar më të lartë prej një portali “qeveritar”, që të punojë për kompensim më të ulët në një medium të pavarur. Kjo më jep shpresë – thotë Protuger.

Jep shpresë edhe fakti që filloi qartë dhe zëshëm të flitet për problemet për çka dëshmon edhe ky tekst, me ç’rast shumica e gazetarëve, edhe pse u është ofruar opsion i atillë, refuzuan të flasin në mënyrë anonime dhe insistonin të shkruhen me emër dhe mbiemër. Vetëm kështu, mundet fuqia e shtatë do të jetë me të vërtetë e fuqishme, do i tejkalojë problemet dhe në fund do të thuhet se beteja ia vlen.

Edhe pse ky shkrim gazetaresk hap çështje shumë serioze, të cilat e pasqyrojnë realisht situatën ekzistenciale tejet të ndërlikuar, në të cilën gjenden pjesa më e madhe e gazetarëve maqedonas pak të paguar – paga mesatare e të cilëve është prej njëqind deri në treqind euro – ne, këtu, megjithatë do të përqendrohemi në një nga problemet më të mëdha të gazetarisë maqedonase që do e kishim kualifikuar si reket shtetëror. Në fakt, me këtë nocion do i kishim përfshirë situatat në vijim: (a) parashtrimi tendencioz i padive për trembje kundër gazetarëve të caktuar, fillimisht hulumtues – edhe atë nga ana e bartësve të funksioneve publike të fuqishme, të cilët, për të qenë ironia më e madhe, janë të paprekshtëm për pushtetin gjyqësor, kur ato do të gjenden në rolin e palës së paditur. Këto mekanizma të verifikuara të trysnisë, janë të papranueshme në një shoqëri demokratike! Ato i përmbushin në tërësi kushtet për tu kualifikuar në grupin famëkeq të të ash.q. SLAPP parashtresa Padi strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut. Respektivisht, sipas vetë definicionit ndërkombëtar të pranuar të letrave të këtilla, kjo është “padi e cila ka për qëllim ti (auto) censurojë, trembë dhe heshtë gazetarët/aktivistët, me atë që do i ngarkojë me taksa dhe harxhime gjyqësore – derisa ato mos i tërheqin kritikën e tyre”; (b) marrja “në pik” e mediemeve të caktuara kritike dhe dënimi i tyre malicioz nga ana e organeve

represive shtetërore, (përmes inspektimeve të ndryshme, përmes Këshillit të Radiodifuzionit si trup rregullator, mandej përmes Drejtorisë të Hyrjeve Publike dhe ngjashëm), dhe e gjithë kjo me qëllim të bërjes së trysnisë që ato ta ndryshojnë politikën e tyre redaktuese. Në rastin e fundit, në rast se këto metoda nuk kanë dhënë rezultat, shkohet deri në pamundësimin e tërësishtëm gj.gj. mbylljen e dhunshme të mediumit; dhe (v) privilegji i mediemeve

të caktuara, nacionale ose lokale, që janë të afërme me pushtetin, dhe favorizimi përmes pagesës së kompensimit për emetimin tepër të shpeshtë të reklamave qeveritare të kampanjës. Dhe që të jetë ironia më e madhe, statusi i punës i gazetarëve të cilët punojnë në këto të ash.q. medime proqeveritare (të pasura/rentabile) është gjithashtu i keq, nëse jo edhe më i keq se ato që punojnë në mediumet e ash.q. kritike!?

Për evitimin e kësaj shtëllunge të problemeve të ndërlidhura mes veti, mundet do të ishte mirë të mendohet, përkaj organizimit sindikal dhe bashkimit qytetar, gazetarët ti orientojnë angazhimet e veta kah krijimi i kooperatave gazetare ose „kolektivëve të lirë“ dhe, duke i shfrytëzuar volitshmëritë që i ofron Ligji për kooperatat (2002), të përpiqen të promovojnë një model tërësishtë ri të të ash.q. gazetari antikorporative që është shumë më vështirë të kontrollohet dhe manipulohet, pasi në këtë mënyrë do të ketë rrjet prej më shumë “foleve” të pavarura, hulumtuese-gazetare ose qelizave që do të merren me problemet reale të shoqërisë dhe me mbrojtjen e interesit publik, pa asnjë mundësi për presione dhe autocensurë.

KOMENT JURIDIK



Degët e ulëta të gazetarisë maqedonase

Censura, mobingu, puna e pasigurt, largimet nga puna, statusi i ulët ekonomik-social - e gjithë kjo është përditshmëria e të punësuarit nëpër medime, pohon hulumtimi të cilin për nevojat e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punëtorëve të Mediumit, e realizoi Agjencia "M-prospekt" nga Shkupi, në të cilin hulumtim ishin përfshirë një ekzemplar reprezentativ prej 300 të anketuarve me ç'rast shumica më e madhe janë gazetarë (98%).

SIPAS ANKETËS,
DERI NË 65
PËRQIND TË
GAZETARËVE E
KANË PËRJETUAR
NË LËKURË TË
VETË CENSURËN A
53 PËRQIND
PRAKTIKOJNË
AUTOCENSURË

Rezultatet nga hulumtimi tregojnë se për shembull, deri 65 përqind të gazetarëve, e kanë ndjerë në lëkurë të vetë censurën ndërsa 53 përqind praktikojnë autocensurim. Censura dhe autocensura nuk mund të funksionojnë nëse nuk ekzistojnë forma të ndryshme të trysnisë mbi medimet dhe mbi gazetarët. Për këtë shkak, të anketuarit kishin detyrë që t'i rangojnë format më të shpeshta të trysnisë, që zbatohet mbi to. Pothuajse gjysma e tyre (49%), e kanë theksuar statusin e tyre ekonomik-social (kanosje për largim nga puna, dënime me para...), si formë e parë e ranguar e trysnisë. Për një

të katërtën e të anketuarve (24%), kjo është censura e drejtpërdrejtë kurse për një pjesë të tyre, presioni kryesor është mobingu (16%), kurse tetë përlind prej tyre, presionin e shohin përmes korrupsionit (telefona falas, ditarë dhe volitshmëri të tjera).

Anketa e hulumton edhe praninë e mobingut në redaksitë. Sipas rezultateve, më shumë se gjysma (60%), kanë përvojë me mobing ose si viktimit ose po si dëshmitarë.

Rezultatet janë alarmuese edhe në pyetjen e lirisë gazetare dhe

integritetit. Më shumë se një e treta e të anketuarve (36 përqind), edhe vetë kanë qenë viktimë të situatës në të cilën gazetari ka qenë i detyruar të nëshkruajë tekst të huaj.

Të anketuarit kishin detyrë ta vlerësojnë edhe rolin e redaktorit në medium edhe të me notat prej 1 deri në 5 (1=Aspak nuk i mbron; 5= tërësisht i mbron). Roli i redaktorit në mbrojtjen e të punësuarve është vlerësuar me notë mesatare prej 3. Pak më e lartë mund të karakterizohet edhe nota mesatare (3,4), e fituar për qëndrimin se redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit, mirëpo, deri 50 përqind të të anketuarve konsiderojnë se redaktori i mbron në tërësi interesat e menaxhmentit, me ç'rast është fituar nota mesatare prej 4,1.

Hulumtimi tregon se më shumë se një e katërta (27%) e gazetarëve profesional praktikisht nuk kanë angazhim ose mbijetojnë “në copë”. Nuk janë në pozitë aspak më të mirë as ato të cilët kanë nënshkruar kontratë në vepër për arsye se kohëzgjatja e e kontratës ndryshon prej kohe në kohë, kurse mesatarja e kohëzgjatjes së kontratave të këtitlla të të anketuarve në hulumtim është më pak se shtatë muaj. Megjithatë, shumica e të anketuarve (59%), akoma kanë kontrata në kohë të pacaktuar.

Prej gazetarëve të punësuar në mënyrë të rregullt, pjesa më e madhe janë të paraqitur në shumën e tërësishme që e pranojnë (87 përqind), tetë përqind janë paraqitur në hyrje më të ulëta, ndërsa pjesa e mbetur i pranojnë “në dorë”, kurse një i anketuar pohon se është paraqitur në shumë të caktuar por një pjesë të rrogës ia kthen pronarit të mediumit.

Deri në 90 përqind të të anketuarve nuk janë të kënaqur nga kompensimi në para për punën e tyre (44 përqind të të anketuarve nuk janë aspak të kënaqur kurse 46 përqind janë “vetëm” të pakënaqur), derisa dhjetë përqind konsiderojnë se janë të shpërblyer në mënyrë përkatëse për punën e tyre.

Sa i takon sigurisë së vendit të punës, më së miri flet e dhëna se deri 27 përqind të të anketuarve, së paku një herë kanë qenë të larguar nga puna, respektivisht kanë mbetur pa punë. Pesë përqind prej tyre theksojnë se arsyeja për largimin tyre nga puna ka qenë padëgjueshmëria e tyre, 14 përqind pohojnë se e kanë braktisur vendin e punës për shkak se nuk kanë mundur t'i durojnë presionet që u janë bërë, 11 përqind, arsyet për largimin e tyre nga puna i karakterizojnë si të paarsyeshme dhe po aq (11%) i konsiderojnë si të arsyeshme. Për pozitën e gazetarëve në shtëpitë e medimeve flet edhe fakti që ato pothuajse aspak nuk janë të inkuadruar në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me statusin e tyre, respektivisht pozitën e tyre ekonomiko-sociale dhe profesionale. Deri në 96 përqind të të anketuarve janë të përjashtuar nga procesi i marrjes së vendimeve që janë me rëndësi jetike për to (dënime, risisteme, ndërrimi i

pronësisë, largime nga puna dhe ngjashëm). Dy të tretat, (67 përqind) nuk janë të inkuadruar aspak, ndërsa informohen pasi që vendimi do të merret; 29 përqind nuk janë të inkuadruar por, janë të informuar në kohë, ndërsa vetëm katër përqind janë të inkuadruar me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me to.

Së këndejmi, nuk na habit pyetja: „Sa jeni të kënaqur nga gjendja momentale e gazetarisë maqedonase?“, shumica e madhe (87%) të të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë të kënaqur. Përgjigje të ngjashme janë fituar edhe në lidhje me gjendjen ekonomike të gazetarëve. Shumica e madhe (79%) thonë se ajo keqësohet, 17 përqind konsiderojnë se mbetet e njëjtë, kurse vetëm për tre përqind ajo përmirësohet.

Rezultatet nga anketa tregojnë perceptim jashtëzakonisht pesimist të të anketuarve dhe të trendëve dhe ngjarjeve në gazetari. Deri në 83 përqind pohojnë se gjendja keqësohet, për 14 përqind mbetet e njëjtë ndërsa vetëm 3 përqind të të anketuarve konsiderojnë se gjendja përmirësohet.

■ Anketë për të drejtat punëtore dhe profesionale në mediumet

Agjencia për hulumtime M-prospekt ngas Shkupi, në periudhën prej 04 deri 20 nëntor të vitit 2013, në bashkëpunim me Sindikatën e Gazetarëve, realizoi një hulumtim në të cilin i hulumtonte qëndrimet e gazetarëve dhe të punëtorëve të mediumeve në lidhje me të drejtat e punës dhe ato profesionale. Hulumtimi u realizua me anë të anketës telefonike, respektivisht nëpërmjet intervistës telefonike të asistuar kompjuterike (CATI), në ekzemplar reprezentativ të rastësishëm prej 300 të anketuarve.¹ Për qëllimet e hulumtimit, ekzemplari përfshiu punëtorë në numër të madh të mediumeve në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast jo të gjithë ishin të organizuar në mënyrë sindikale.² Sipas tipit të mediumit në të cilin janë të angazhuar, më të përfaqësuar janë gazetarët televiziv me 41%, prej mediumeve të shtypura janë 29%, mediume onlajn 20%, radio 6% dhe gazetarë që për momentin janë pa asnjë angazhim 3%. Mesatarja e të punësuarve që ishin pyetur është 14,8 vite pa përvojë pune. Në anketë 52% të të anketuarve ishin burra, ndërsa 48% gra. Përkatësi etnike e të anketuarve është si vijon: 87% maqedonas, 7% shqiptar, 3% serb dhe nga 1% turke dhe përfaqësim tjetër.


Rezultatet i nënshtrohen gabimit prej $\pm 5\%$ me interval të sigurisë prej 95%.

¹ Në fokusin e këtij hulumtimi ishin gazetarët. përfaqësimi procentual i punëtorëve të tjerë të mediumeve është minimale dhe është nën 2%.

² Data baza (numrat telefonikë) është siguruar nga ana e Sindikatës dhe ajo doli prej fletëregjistrimeve të anëtarëve, pjesëmarrësve të debateve, konferencave dhe seminareve të LSGM.

1. Pyetje në lidhje me të drejtat e punës të gazetarëve dhe të punëtorëve të medimeve

Pyetje: Si e vlerësoni pozitën ekonomike sociale të gazetarëve dhe të punëtorëve të medimeve?



Shumica e madhe e të anketuarve (80%) janë përgjigjur se situata me mediumet në Maqedoni, në aspekt të pozitës ekonomike keqësohet. Të tjerët 17% janë përgjigjur se situata mbetet e njëjta, a vetëm 3% se përmirësohet.

Pyetje: A keni qenë dëshmitar ose viktimë mobingu?



Shumica e të anketuarve ose kanë qenë viktimë ose dëshmitar mobingu. Prej tyre, 6% kanë qenë viktimë mobingu, 23% kanë qenë dëshmitarë kurse 31% të të anketuarve kanë qenë edhe viktimë edhe dëshmitarë mobingu. Më pak se gjysma, 40% të të anketuarve thonë se nuk kanë qenë as viktimë as dëshmitarë mobingu.


Pyetje: A konsideroni se jeni të paguar në mënyrë përkatëse për angazhimin, arsimin dhe përvojën e juaj?

A konsideroni se jeni të paguar në mënyrë përkatëse për angazhimin, arsimin dhe përvojën e juaj?	Numër	%
Po	32	11
Pjesërisht	137	46
Jo aspak	131	44
Gjithsej	300	100

Deri në 90 përqind të të anketuarve nuk janë të kënaqur nga kompensimi me para për punën e tyre (44 përqind aspak nuk janë të kënaqur kurse 46 përqind janë "vetëm" të pakënaqur), ndërsa dhjetë përlind konsiderojnë se janë të shpërblyer në mënyrë përkatëse për punën e vet.

Pyetje: Çfarë statusi të punës keni?

Çfarë status pune keni?



Më shumë se një e katërta e gazetarëve dhe punëtorëve të mediumit nuk kanë angazhim pune stabil dhe të sigurt. Të angazhuar përkohësisht me kontratë në vepër janë 17% (fri lens), me kontratë në kohë të caktuar janë 12%, kurse të tjerët 11% janë pa asnjë kontratë me shkrim, të papunësuar dhe pensionistë. Kohëzgjatja mesatare e kontratës në kohë të caktuar e gazetarëve është 6,4 muaj. Megjithatë, anketa tregon se më shumë se gjysma nga të anketuarit janë prononcuar se punojnë me kontratë në kohë të pacaktuar (59%).

Pyetje: Në rast se keni kontratë, a është për orar të plotë ose gjysmë të plotë të punës?

P5: A keni kontratë për orar të plotë ose gjysmë të plotë të punës?	Numri	%
Orar i plotë i punës	207	69
Orar gjysmë i plotë i punës	11	4
Refuzon të përgjigjet	1	0
Nuk përgjigjen në pyetjen	81	27
Gjithsej	300	100

Prej të anketuarve që kanë kontratë, shumica thonë se kanë kontratë për orar të plotë të punës (69%) por, konfirmohet edhe praktika që punëtorët e medimeve të paraqiten në orar gjysmë të plotë të punës, gjegjësisht, 11 të anketuar ose po 4% kanë deklaruar se janë të paraqitur në orar gjysmë të plotë të punës.

Pyetje: Në rast se jeni të punësuar, në cilën mënyrë janë paraqitur hyrjet e juaja?

P9: Në cilën mënyrë janë paraqitur hyrjet e juaja?	Numri	%
Jam i/e paraqitur në shumë më të vogël/ pjesën tjetër e marr në dorë	18	6
Jam i/e paraqitur në shumë të caktuar por, një pjesë të pagës ia kthej punëdhënësit	1	0
Jam i/e paraqitur në tërë shumën që e pranoj	202	67
Tjetër	10	3
Gjithsej	231	77
Nuk përgjigjen në pyetjen	69	23
Gjithsej	300	100

Prej gazetarëve rregullisht të punësuar, pjesa më e madhe janë të paraqitur në shumën e tërësishme që e pranojnë (67 përqind), gjashtë përlind janë paraqitur në shumën më të ulët ndërsa pjesën tjetër e pranojnë "në dorë", ndërsa një i anketuar pohon se është i paraqitur në shumë të caktuar por një pjesë të pagës ia kthen pronarit të mediumit.

Pyetje: sa janë gazetarët dhe punëtorët e medimeve të përfshirë në vendimet që janë me interes për pozitën e tyre ekonomiko-sociale dhe profesionale? (Ndërrimi i pronarit, përcaktimi i politikave redaktuese, sistematizimi, përparimi, zvogëlimi i pagave, punësimet e reja ose pushimet nga puna dhe ngjashëm)

Sa janë të përfshirë gazetarët dhe punëtorët e medimeve në vendimet që janë me interes për pozitën e tyre ekonomiko-sociale dhe profesionale?	Numri	%
Po, janë tërësisht të përfshirë	12	4
Nuk janë të përfshirë, por janë të informuar në kohë	87	29
Nuk janë të përfshirë aspak, informohen pasi që vendimet të merren	200	67
Nuk e di	1	0
Gjithsej	300	100

Përqindja kumulative e të punësuarve që nuk janë të përfshirë është 96%. Dy të tretat e të anketuarve janë përgjigjur se të punësuarit nuk janë të përfshirë aspak në vendimet që janë me interes për pozitën e tyre ekonomiko-sociale dhe profesionale, a informohen pasi që vendimi të merret. Dyfish më e ulët është përqindja (29%) e atyre që nuk janë aspak të përfshirë, por janë të informuar në kohë.

Pyetje: A flet udhëheqësia për stërpunësim dhe për cilat arsye?

P26: A flet udhëheqësia në mediumin tënd për stërngarkim?	Numri	%
Po, me qëllim që të bëhet trysni mbi gazetarët	101	34
Po, pasi realisht ekziston stërpunësim	19	6
Nuk flet për stërpunësim	169	56
Gjithsej	289	96
Nuk e di	8	3
Refuzon të përgjigjet	3	1
Gjithsej	300	100

Shumica e të anketuarve, 56%, kanë thënë se udhëheqësia nuk flet për stërpunësim, kurse 34% kanë deklaruar se kjo bëhet me qëllim që të bëhet trysni e caktuar mbi të punësuarit. Për stërpunësim real flasin 19 të anketuar ose 6%, me nuk e di ose po kanë refuzuar të përgjigjen 11 të anketuar ose po 4%.


Pyetje: Për cilat arsye e keni ndërruar vendin e punës në karrierën e juaj?

P12: Për cilat arsye e keni ndërruar vendin e punës?	Përgjigje	
	N	%
Punoj në vendin e njëjtë të punës prej fillimit të karrierës sime	83	24%
Për pozitë të paguar më mirë	112	32%
Isha i/e pushuar nga puna si e padëgjueshme (pavarësisht se çfarë arsye formale është theksuar)	16	5%
Isha i/e përjashtuar për shkaqe të arsyeshme	38	11%
Isha përjashtuar për shkaqe të paarsyeshme	39	11%
E braktisa vendin e punës për arsye se nuk mundesha t'i duroj trysnitë	47	14%
Nuk e di	8	2%
Refuzon të përgjigjet	4	1%
Gjithsej përgjigje	347	100%

Pyetja që ka të bëjë me sigurinë në vendin e punës, jepte mundësi për më shumë përgjigje. Rezultatet tregojnë se deri 27 përqind të përgjigjeve sugjerojnë se të anketuarit së paku një herë kanë qenë të pushuar nga puna, respektivisht kanë mbetur pa punë. Në 5% të rasteve theksojnë se arsyeja për pushimin e tyre ka qenë padëgjueshmëria e tyre, 11 përqind i karakterizojnë arsyet për pushimin e tyre si të arsyeshme, ndërsa përqindja e rasteve kur arsyet kanë qenë të paarsyeshme është e njëjtë. Është interesant se deri 47 prej përgjigjeve ose po 14% të rasteve pohojnë se gazetarët ndonjëherë e kanë braktisur vendin e punës për arsye se nuk kanë mundur t'i durojnë trysnitë

2.Rezultatet e pyetjeve në lidhje me të drejtat profesionale të gazetarëve

Pyetje: Sa jeni të kënaqur me gjendjen momentale të gazetarisë në Maqedoni?



Është evidente pakënaqësia e përgjithshme e gazetarisë në Maqedoni, e shprehur nga një pjesë e madhe e të anketuarve, respektivisht gjithsej 87%. Prej tyre 55% nuk janë aspak të kënaqur ndërsa 32% nuk janë të kënaqur. Vetëm 10% të të anketuarve janë të kënaqur nga gjendja.

Pyetje: Vlerësoni situatën me mediumet në Maqedoni nga aspekti i pozitës profesionale të gazetarëve?

Si është situata me mediumet në Maqedoni, në aspekt të pozitës profesionale të gazetarëve?	Numri	%
Përmirësohet	9	3
Mbetet e njëjta	43	14
Keqësohet	248	83
Gjithsej	300	100

Shumica e madhe e të anketuarve (83%) konsiderojnë se situata me mediumet në Maqedoni, në aspekt të pozitës profesionale të gazetarëve keqësohet, ndërsa 14% të tjerët konsiderojnë se mbetet e njëjta.

Pyetje: Rangimi i mënyrave të presionit sipas asaj se sa shpesh përdoren

P16_1: A do të mundeni ti rangoni arsyet për presion mbi punëtorët e mediumit, sipas asaj se sa shpesh praktikohen?	Numri	%
Ndikimi mbi statusin ekonomik-social (përrjashtim nga puna, zvogëlim i pagës)	148	49
Censurë e drejtpërdrejtë	72	24
Mobing	49	16
Korrupsion (telefona të paguar, udhëtime, mëditje)	23	8
Kanë refuzuar	8	3
Gjithsej	300	100

Në pyetjen për mënyrat më të përfaqësuara të presionit mbi punëtorët e mediumit, duhej të rangohen 4 pyetje të ofruara. Me ç'rast, gjysma e të anketuarve (49%), e zgjedhën ndikimin mbi statusin ekonomik-social, si të ranguar të parë. Një e katërta (24%), e kanë zgjedhur censurën e drejtpërdrejtë si të ranguar të parë, ndërsa mobingun si të ranguar të parë e kanë zgjedhur 16% të të anketuarve. 8% e mbetur e kanë zgjedhur korrupsionin. Ajo që mund të konkludohet është se në numrin më të madh të rasteve, kur qëllimi është të detyrohen gazetarët, ndikohet mbi statusin e tyre ekonomik-social (përrjashtim nga puna, zvogëlimi i pagës etj.)

Pyetje: A keni përjetuar në karrierë censurë?

A keni përjetuar në karrierë censurë?	Numri	%
Kurrë nuk kam përjetuar	101	34
Kam përjetuar censurë të drejtpërdrejtë	196	65
Refuzon të përgjigjet	3	1
Gjithsej	300	100

Pothuajse dy të tretat e të anketuarve, 65% kanë përjetuar censurë të drejtpërdrejtë ndërsa 3 të anketuar ose po 1% refuzojnë të përgjigjen. Dyfish më e vogël është përrqindja (34%) e atyre që kurrë nuk kanë përjetuar censurë.

Pyetje: A praktikoni autocensurë?

P15: A keni praktikuar autocensurë në karrierë?	Numri	%
Po, praktikoj	158	53
Nuk praktikoj	138	46
Refuzon të përgjigjet	4	1
Gjithsej	300	100

Shumica e të anketuarve, 158 ose 53%, thonë se praktikojnë autocensurë, 4 të anketuar ose 1%, refuzojnë të përgjigjet ndërsa 46%, respektivisht 138 të anketuar, thonë se nuk praktikojnë autocensurë.

Tabela tregon se ekziston përputhje e madhe ndërmjet atyre që praktikojnë autocensurë dhe atyre që kanë përjetuar censurë (78%). Numrat tregojnë se në rast se dimë[se gazetari praktikon autocensurë, është e madhe mundësia që ta gjejmë se ka përjetuar censurë.


Rezultate të kryqëzuara ndërmjet përvojës me censurë dhe praktikimit të autocensurës		P15.A keni praktikuar autocensurë në karrierë?	
		Po, praktikoj	Nuk praktikoj
		%	%
P14. A keni përjetuar censurë në karrierë?	Kurrë nuk kam përjetuar	22	48
	Kam përjetuar censurë të drejtpërdrejtë	78	52

Pyetje: A ekziston praktikë në redaksi të refuzohet temë, në rast se ajo është në kundërshtim me standardet etike të informimit?

A ekziston praktikë në redaksi të refuzohet temë, në rast se ajo është në kundërshtim me standardet etike të informimit?	Numri	%
Po	198	66
Jo	91	30
Refuzon të përgjigjet	11	4
Gjithsej	300	100


Më shumë se dy të tretat e të anketuarve (66%), janë përgjigjur se në redaksinë e tyre ekziston praktikë të refuzohet temë, në rast se ajo është në kundërshtim me standardet etike të informimit. Të tjerët 30% janë përgjigjur anasjelltas, a 4% kanë refuzuar të përgjigjen.

Pyetje: A keni qenë të detyruar të nënshkruhen në tekst i cili nuk është i juaji ose keni qenë dëshmitar i situatës së atillë?



Një e treta e të anketuarve (36%), kanë qenë të detyruar të nënshkruhen në tekst i cili nuk ka qenë i tyre ose po kanë qenë dëshmitarë të një situatë të atillë. Dy të tretat ose po 64% thonë se nuk kanë qenë as viktima, as dëshmitarë të praktikës së atillë në redaksitë.

Qëndrim: Redaktori i mbron interesat e punëtorëve të punësuar në medime



Në pyetjen nëse redaktori i mbron interesat e gazetarëve, në shkallë prej 1 deri në 5 (ku 1 = aspak nuk i mbron; 5 = tërësisht i mbron), mendimet e gazetarëve janë shpërndarë në mënyrë të barabartë nëpër të gjitha vlerësimet. Përqindja më e madhe (26%) vërehet te vlerësimi 3 që shënon qëndrim neutral. Vijnë 23% me vlerësimin 2 dhe 22% me vlerësimin 5.

Vlerësimi mesatar është 3.

Qëndrim: Redaktori i mbron interesat e profesionit.

P24_2: Redaktori i mbron interesat e profesionit në tërësi	Numri	%
1 nuk i mbron aspak	42	14
2	67	22
3	84	28
4	43	14
5 i mbron tërësisht	62	21
Refuzon të përgjigjet	2	1
Gjithsej	300	100

Në pyetjen nëse redaktori i mbron interesat e profesionit, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 = nuk i mbron aspak; 5 = i mbron tërësisht), ngjashëm si edhe pyetja paraprake, përqindja më e madhe e gazetarëve (28%) kanë dhënë vlerësim 3. Viojnë 22% me vlerësim 2 dhe 21% me vlerësim 5.

Vlerësimi mesatar është 3,1.


Qëndrimi: Redaktori i mbron interesat e menaxhmentit.

P24_3: Redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit	Numri	%
1 nuk i mbron aspak	8	3
2	14	5
3	52	17
4	70	23
5 tërësisht i mbron	150	50
Refuzon të përgjigjet	6	2
Gjithsej	300	100

Në pyetjen nëse redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit, në shkallën prej 1 deri 5 (1 = aspak nuk i mbron; 5 = i mbron tërësisht), për dallim nga përgjigjet në pyetjet paraprake, qartë veçohet një përgjigje. Gjysma e të anketuarve (50%), kanë dhënë vlerësim 5 gj.gj. janë përgjigjur se redaktori tërësisht i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit. Viojnë 23% me vlerësimin 4. Shuma kumulative e pajtimit me deklaratën është 73%, që shënon shumicë enorme, përkundër pakicës prej 17%, të cilët kanë qëndrim neutral dhe vetëm 3% të cilët konsiderojnë se redaktori nuk i mbron/aspak nuk i mbron interesat e menaxhmentit.

Nota mesatare është 4,2, njëkohësisht edhe sugjeron shkallë më të lartë të pajtimit me qëndrimin se redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit ose po, të qendrave të caktuara të pushtetit, krahasuar me mbrojtjen e interesave të të punësuarve ose të profesionit në përgjithësi.

Qëndrimi: Redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit.



Në pyetjen nëse redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 = aspak nuk i mbron; 5 = tërësisht i mbron), një e treta e të anketuarve konsideron se redaktorët i përfaqësojnë në tërësi interesat e qendrave të caktuara të pushtetit kurse 26% prej tyre kanë dhënë vlerësim 3. Vlerësimi mesatar është 3,4.

Teste të korrelacionit

Ekziston korrelacion pozitiv ndërmjet kënaqësisë prej gjendjes në gazetari dhe perceptimit për atë se a i mbron redaktori interesat e të punësuarve dhe të profesionit. Ato të cilët kanë shprehur kënaqësi më të madhe prej asaj se si i mbron redaktori interesat e gazetarëve të punësuar, në shkallë më të lartë u pajtuan me deklaratën se redaktorët i mbrojnë interesat e profesionit në tërësi.

Njëkohësisht, ekziston korrelacion negativ ndërmjet shkallës së pajtimit me deklaratën se redaktori i mbron interesat e gazetarëve dhe/ose profesionit përkundër interesave të menaxhmentit dhe/ose qendrave të caktuara të pushtetit. Të anketuarit të cilët në shkallë më të madhe u pajtuan me deklaratën se redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit, në shkallë të lartë janë pajtuar edhe me atë se redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit.

Ndërmjet perceptimit se redaktori i mbron interesat e të punësuarve, respektivisht interesat e profesionit në përgjithësi dhe se redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit, ekziston korrelacion i fuqishëm negativ. Thënë ndryshe, gazetarët të cilët kanë shprehur pajtim më të madh me qëndrimin se redaktori i mbron interesat e të punësuarve ose të profesionit në përgjithësi, në shkallë shumë të ulët pajtohen se redaktori mbron interesa të qendrave të caktuara të pushtetit.

Koeficienti Spirman		P6. Sa jeni të kënaqur me gjendjen momentale të gazetarisë në Maqedoni?	P24_1: Redaktori i mbron interesat e punëtorëve të punësuar të mediumit	P24_2: Redaktori i mbron interesat e profesionit në përgjithësi	P24_3: Redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit
P24_1: Redaktori i mbron interesat e punëtorëve të punësuar të mediumit	Koeficient Sig. Numri i të anketuarve	.387** .000 297			
P24_2: Redaktori i mbron interesat e profesionit në përgjithësi	Koeficient Sig. Numri i të anketuarve	.430** .000 297	.745** .000 298		
P24_3: Redaktori i mbron interesat e menaxhmentit të mediumit	Koeficient Sig. Numri i të anketuarve		-.343** .000 294	-.293** .000 294	
P24_4: Redaktori i mbron interesat e qendrave të caktuara të pushtetit	Koeficient Sig. Numri i të anketuarve	-.283** .000 292	-.584** .000 293	-.612** .000 293	.411** .000 291

¹ Korrelacion është analizë statistikore që e tregon shkallën deri te cila ndryshimet te njëra variabël shoqërohen me ndryshime edhe të tjetrës. Në varësi se në cilin drejtim janë ndryshimet, korrelacioni mund të jetë pozitiv ose negativ. Korrelacioni pozitiv e shënon shkallën deri te e cila variablat rriten ose zvogëlohen në mënyrë paralele. Korrelacioni negativ e shënon shkallën deri te e cila njëra variabël rritet derisa tjetra zvogëlohet në mënyrë paralele

Për gazetarët dhe ato tjerët

Drama e gazetarisë nuk është abstrakte. Është dramë konkrete, "dramë popullore" e gjallë e gazetarëve dhe të punësuarve në medime.

Është dramë e nënave me asistencë të cilat pajtohen që gjysmën e rrogës t'ia kthejnë pronarit që ai me ato para ti paguajë "ato me honorarë", është ky rrëfimi ekzistencial i mallëngjyeshëm i kolegëve

me nga 40 vite pa as edhe një ditë stazh pune, për arsye se tërë jetën kanë punuar të paevidentuar, këto janë faktet të cilat turpërohem ti shqiptojmë në mënyrë publike. Faktet për heshtjen, për jodinjitetin, për nënçmimin, për pajtimin në emër të "ekzistencës", në emër të asaj shume qesharake që do e sjellim në shtëpi. Jepen pushime nga puna, mbyllen vende pune, medime të reja paraqiten si aktivitete projektuese ku njerëzit janë zëra buxhetore e jo të punësuar, por, përsëri janë të lumtur pasi punojnë së paku diçka. Në sytë e pronarëve, por për fat të keq, gjithnjë e më shpesh edhe në sytë e redaktorëve, punëtorët e

medimeve tani më nuk janë profesionistë me njohuri dhe me talent por janë numra që lehtë mund të shlyhen dhe të zëvendësohen me numra të reja kurse parimet e profesionit, përralla për fëmijët e vegjël ose po rrëfimet ë bukura për ndonjë "kohë tjetër". Prandaj, e folura ose po apelimi në standarde, në etikë, në integritet profesional, për shumë kolegë paraqet bile edhe ofendim. Për shkak se i rikujton në jodinjitetin që e jetojnë çdo ditë. Me kontrata për punësim, nëse edhe ato ekzistojnë, të cilat kontrata skadojnë çdo

DRAMA E
GAZETARISË NUK
ËSHTË ABSTRAKTE.
ËSHTË DRAMË
KONKRETE, "DRAMË
POPULLORE" E
GJALLË E
GAZETARËVE DHE
TË PUNËSUARVE NË
MEDIUME

muaj dhe të cilat shumë lehtë mund të mos ripërtërihen, me paga me vonesë, me aranzhime gojore për punësim të cilat munden aq lehtë të ndërpriten, pas dhjetë vite bashkëpunim, me një tekst mesazh me anë të celularit.

Dikush mund të thotë se ashtu është në të gjithë sektorët, se gazetarët nuk janë asgjë e veçantë dhe nuk meritojnë të veçohen nga rrëfimi i përgjithshëm, por, nuk është ashtu. Efektet nga shkatërrimi i industrisë së medimeve, kufizimi i saj në një pronë koloniale nën kontrollin e një ose më shumë eksploatorëve të marrë, pauperizmi i forcës së punës ndikon drejtpërdrejtë në lirinë e informimit dhe të shprehurit që janë një supozim i të gjitha lirive të tjera dhe themeli i dinjitetit njerëzor.

Puna e pasigurt, e paguar dobët, prej gazetarëve bën njerëz të cilët nuk munden t'i kundërvihen presionit, impulseve autoritare ose po korrupsionit. Roli i tyre për të qenë kundërpesha e ambicieve për keqpërdorimin e fuqisë, pa dallim se prej cilës anë manifestohet ajo, është reduktuar në minimum.

Një vend pa medime me politikë redaktuese të pavarur, pa dallim në burimet e financimit, është vend në të cilin gazetaria dalë ngadalë po shuhet dhe çmimin për këtë do e paguajë e tërë shoqëria. Për këtë arsye, çështja e gjendjes së medimeve është çështje e të gjithëve dhe jo vetëm çështje e gazetarëve, e sindikatave dhe shoqatave të tyre.

Për shkak se, kur gazetarët janë të nënshtruar në manipulim, vetë ato bëhen burimi i manipulimit, i sensacionalizmit, fjalimit të urrejtjes, informimit mercenar - në vend të informimit në favor të interesit publik.

Për arsye se, gazetarët që heshtin dhe që frikohen, nuk do i parashtrajnë pyetjet kryesore dhe nuk do i ballafaqojnë pushtetarit me përgjegjësinë e tyre dhe me kritikën për punën e tyre.

Për shkak se, pagat e vogla, pasiguria profesionale dhe statusi i keq i dëbon dhe i persekuton nga profesioni ato të talentuarit, të guximshmit ndërsa solidaritetin profesional e bën të pamundur. Gjithnjë e më pak profesionalistë me integritet qëndrojnë në mbrojtje të profesionit nga "ardhacakët" propagandist, të cilët fshihen prapa misionit fisnik të gazetarisë dhe e ndytin hapësirën publike.

Mediumet propagandistike nuk janë të rrezikshëm vetëm për shkak se aty nuk do i shihni pyetjet e vërteta, storjet huluntuuese., temat me interes publik. Ato, janë të rrezikshme edhe për arsye se ndikojnë në mënyrë demoralizuese, e pasivizojnë opinionin i cili zhytet në mosbesim politik dhe rezignacion, mësohet që të paligjshmen ta konsiderojë si të ligjshme dhe së paku, "normale". Mediumet e atilla e vrasin frymën, aftësinë për të reaguuar dhe për tu kundërvënë.

Nëse gazetaria kritike, e lirë është shtylla e demokracisë, promotor i debatit, i këmbimit të ideve dhe kritiku kujdestar i keqpërdorimit të pushtetit, atëherë heshtja dhe injorimi i shuarjes së gazetarisë janë deviza se "kjo nuk është puna jonë," atëherë të gjithë pjesëmarrësit në jetën publike, të gjitha profesionet dhe të gjitha adresat i bën bashkëpjesëtarë në vrasjen e profesionit që është i domosdoshëm për të gjithë. Dhe, pasojat do i ndjejnë të gjithë. Pa përjashtime.

Tamara Çausidis

